



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

VJETARI STATISTIKOR 2025

TIRANË, 2026

VJETARI STATISTIKOR 2025




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
Bulevardi "Zogu i I" Tiranë, Shqipëri

www.drejtesia.gov.al
info@drejtesia.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E DREJTËSISË

VJETARI STATISTIKOR

2025

Tiranë, 2026

Botim i Ministrisë së Drejtësisë

Spektori i Monitorimit, Jetësimi të Prioriteteve dhe Statistikave

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë

Viti i njëzetë e tretë i botimit

Punoi:

Anairda Arizaj – Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit,
Jetësimi të Prioriteteve dhe Statistikave;

Mirela Llaperi - Specialist në Sektorin e Monitorimit,
Jetësimi të Prioriteteve dhe Statistikave;

Saimir Topuzi - Specialist në Sektorin e Monitorimit,
Jetësimi të Prioriteteve dhe Statistikave

LËNDA

FJALA PËRSHËNDETËSE.....	4
H Y R J A	5
KREU I: STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET PENALE DHE ÇËSHTJET CIVILE TË GJYKUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË	12
KREU II: KLASIFIKIMI I ÇËSHTJEVE PENALE DHE ANKIMIMET.....	29
KREU III: TË DHËNAT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE	66
KREU IV: SHPËRNDARJA E KRIMINALITETIT GJATË VITIT 2025, BAZUAR NË ÇËSHTJET PENALE TË PËRFUNDUARA	77
KREU V: ÇËSHTJET E GJYKUARA PËR KRIMET E KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR	82
KREU VI: ÇËSHTJET E GJYKUARA PËR KRIMET NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË SIPAS KODIT PENAL USHTARAK	97
KREU VII: KRIMINALITETI PËR TË MITURIT	106
KREU VIII: PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT ME BURGIM, SHËRBIMI I PROVËS, ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME BURGIM DHE MBIKËQYRJA ELEKTRONIKE	115
KREU IX: NGARKESA E GJYQTARËVE	133
KREU X: ANALIZË STATISTIKORE KRAHASUESE PËR ÇËSHTJET PENALE TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E APELEVE	140
KREU XI: ÇËSHTJET CIVILE TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË DHE GJYKATAT ADMINISTRATIVE	175
KREU XII: ANALIZË STATISTIKORE KRAHASUESE PËR ÇËSHTJET CIVILE TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E APELEVE	216
KREU XIII: STATISTIKË ANALITIKE SIPAS RRETHEVE GJYQËSORE	244
KREU XIV: STATISTIKAT PËR PROCEDIMET PENALE DHE DINAMIKËN E TYRE NË PROKURORI	263
KREU XV: TË DHËNAT STATISTIKORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR	285
KREU XVI: STATISTIKË ANALITIKE SIPAS RRETHEVE GJYQËSORE MBI DHUNËN NË FAMILJE	291
KREU XVII: TË DHËNAT E DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS	309
KREU XVIII: EFIÇENCA, BURIMET NJERËZORE DHE LLOGARIDHËNIA NË SISTEMIN E DREJTËSISË	323

Të nderuar partnerë, kolegë dhe miq,

Ky është botimi i njëzet e tretë i Vjetarit Statistikor të Sistemit të Drejtësisë. Pas këtij botimi qëndrojnë më shumë se dy dekada përpjekjesh për të ndërtuar një kulturë matjeje, transparence dhe llogaridhënieje në sistemin e drejtësisë; një përpjekje e vazhdueshme për ta parë sistemin me objektivitet, me disiplinë institucionale dhe me gatishmërinë për të pranuar atë që tregojnë faktet.

Edicioni i këtij viti shënon një hap cilësor. Për herë të parë, të dhënat janë mbledhur dhe përpunuar mbi bazën e një metodologjie të unifikuar kombëtare, të harmonizuar me të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë. Kjo nuk është vetëm një arritje teknike; është themeli mbi të cilin mund të krahasojmë, të mësojmë dhe të ushtrojmë llogaridhënie me ndershmëri. Statistikat e drejtësisë nuk janë raporte për arkivë. Ato janë një pasqyrë e funksionimit të sistemit: tregojnë sa kohë pret qytetari, sa vendime zbatohen, sa i aksesueshëm është sistemi dhe sa larg apo pranë ndodhet ai ndaj nevojave të njerëzve. Në demokracitë moderne, cilësia e drejtësisë matet gjithnjë e më pak nga numri i ligjeve të miratuara dhe gjithnjë e më shumë nga distanca midis asaj që garanton ligji dhe asaj që përjeton qytetari. Vjetari është një nga instrumentet që na ndihmon ta masim këtë distancë.

Të dhënat e vitit 2025 evidentojnë progres në disa tregues të rëndësishëm të funksionimit të sistemit, veçanërisht në drejtëm të efikasitetit, zbatimit të vendimeve dhe aksesit në drejtësi. Njëkohësisht, disa sfida mbeten të qëndrueshme: kohëzgjatja e proceseve, shpërndarja gjeografike e shërbimeve dhe niveli i besimit të publikut ndaj sistemit. Kultura e evidencës nuk ka kuptim nëse e zbatojmë vetëm kur shifrat janë të pëlqyeshme.

Në kontekstin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, kjo qasje merr një rëndësi të veçantë. Standardet europiane nuk mjaftohen me reforma të miratuara; ato kërkojnë prova të matshme të rezultateve. Ky Vjetar është, në këtë kuptim, edhe një dëshmi institucionale se sistemi ynë është i gatshëm të vlerësojë performancën e vet mbi bazën e fakteve dhe jo të perceptimeve.

Mbi bazën e këtij botimi, Ministria e Drejtësisë ka nisur punën për ndërtimin gradual të Barometrit Kombëtar të Drejtësisë, një instrument monitorimi të rregullt, publik dhe të kuptueshëm, i cili do të mundësojë ndjekjen e performancës së sistemit jo vetëm nga institucionet dhe politikëbërësit, por edhe nga academia, media, shoqëria civile dhe qytetarët. Barometri nuk do ta zëvendësojë Vjetarin; ai do ta plotësojë atë, duke i bërë të dhënat më të aksesueshme, më të krahasueshme dhe më të dobishme për publikun.

Pas çdo treguesi statistikor qëndrojnë histori njerëzore: qytetarë që kërkojnë drejtësi, familje që presin zgjidhje dhe profesionistë që mbajnë mbi supë përgjegjësi të mëdha publike. Pikërisht për këtë arsye, transparenca nuk është vetëm publikim i të dhënave; ajo është aftësia për t'i kthyer ato në njohuri që ndihmojnë përmirësimin e sistemit dhe i shërbejnë njerëzve.

U shpreh mirënjohjen të gjitha institucioneve që kontribuan në përgatitjen e këtij botimi. Një falënderim i veçantë shkon për specialistët e statistikës dhe të analizës së të dhënave në Ministrinë e Drejtësisë dhe në institucionet partnere, puna profesionale dhe shpeshherë pak e dukshme e të cilëve bën të mundur prodhimin e informacionit të besueshëm mbi të cilin mbështeten politikat publike, proceset e reformës dhe vendimmarrja institucionale.

Në një kohë kur debati publik shpesh zhvillohet me ritëm më të shpejtë sesa verifikimi i fakteve, puna e heshtur dhe e kujdesshme e profesionistëve që mbledhin, verifikojnë dhe analizojnë të dhënat mbetet një nga garancitë më të rëndësishme të vendimmarrjes së përgjegjshme.

Ftoj studiuesit, organizatat e shoqërisë civile, median, partnerët ndërkombëtarë dhe çdo të interesuar të angazhohen me këto të dhëna, jo vetëm për t'i lexuar, por edhe për t'i analizuar, sfiduar dhe përmirësuar. Edhe ky instrument, ashtu si vetë sistemi i drejtësisë, duhet të jetë në zhvillim të vazhdueshëm.

Një drejtësi më e mirë ndërtohet mbi institucione të forta, profesionalizëm, transparencë dhe mbi aftësinë për të matur me ndershmëri progresin tonë.

Toni Gogu

Ministër i Drejtësisë

HYRJA

Sipas ligjit nr.17, datë 05.04.2018 **“Për statistikat zyrtare”**, me termin **“Statistikë”** është informacioni sasior dhe cilësor, i përmbledhur dhe përfaqësues që karakterizon një dukuri kolektive në një popullatë të dhënë, etj., duke mbledhur të dhëna numërore për to, të cilat grupohen e përpunohen me metoda të veçanta.

“Prodhim i statistikave” janë të gjitha veprimtaritë e nevojshme për përgatitjen, mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, përmbledhjen, analizën, interpretimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore. Statistika gjithashtu paraqet tërësinë e të dhënave numërore të mbledhura nga një fushë e jetës, e ekonomisë etj. për një dukuri dhe të renditura sipas një kriteri të caktuar për të karakterizuar fenomene kolektive në një popullim të dhënë.

Indekset: janë tregues relativ të cilët paraqesin raportin e nivelit të caktuar të dukurive të ndryshme në periudha të caktuara kohore. Ata mund të paraqiten si raport i dy niveleve të veçanta apo si raport i niveleve të grupuara. Ndryshe quhen edhe tregues të dinamikës sepse paraqesin krahasimin përmes faktorit kohor.

Statistika juridike, si një pjesë e statistikës së përgjithshme, duke patur kolektivitet krejt të veçantë, studion gamën e gjerë të problemeve juridike që përmbledh dhe shërben si syri dhe mendja nga ku shikohet dhe bëhet anatomia e zhvillimit kualitativ dhe kuantitativ e pushtetit gjyqësor të një vendi. Ministria e Drejtësisë e ka konsoliduar traditën e saj në botimin e vjetarëve duke paraqitur në mënyrë të detajuar të dhëna dhe analiza për Sistemin e Drejtësisë.

Qëllimi ynë në këtë botim, është krijimi i një statistike të unifikuar për drejtësinë, ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr.8678 datë 14.05.2001 **“Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”**, të ndryshuar. Kjo është realizuar nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga më shumë se një burim dhe krijimit të një situatë ku të dhënat të interferohen duke verifikuar saktësinë e tyre. Kështu p.sh. të dhënat e marra nga Prokuroria e Përgjithshme për çështjet e dërguara për gjyq, ballafaqohen me çështjet e ardhura të reja për gjykatën, ku merren në konsideratë edhe ato çështje të ardhura në gjykatë me ankim nga i dëmtuari akuzues, informacioni për urdhrat e ekzekutimit që jep prokuroria, ballafaqohet me të burgosurit e rinj të ardhur në burgje ose çështjet e reja nga përbarimi sipas rastit konkret; të dhënat për ankimimet merren nga tre shkallët e gjykatave dhe konkludohet për saktësinë e tyre.

Burimi kryesor në sigurimin e informacionit statistikor janë Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ, Gjykata e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës. Marrëdhëniet me këto institucione, krahas detyrimeve ligjore nëpërmjet ligjit nr. 97, datë 06.10.2016 **“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”** dhe ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 **“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”**, janë rregulluar nëpërmjet akteve nënligjore, si urdhra dhe udhëzime të Ministrit të Drejtësisë, ku në fuqi janë **urdhëri nr. 250, date 15.04.2019 “Për miratimin e formateve të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore nga Gjykatat në Republikën e Shqipërisë, udhëzimi nr.4, datë 15.04.2019 “Për plotësimin e të dhënave statistikore”, udhëzimi nr. 804/1 datë 23.12.2013 “Për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar”**. Materiali statistikor përcillet në Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet formularëve të plotësuar me të dhënat sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrit të Drejtësisë.

Si rregull, ky informacion plotësohet nga kancelari i gjykatës ose nën kujdesin e tij dhe kontrollohet nga kryetari i gjykatës.

Burim tjetër i rëndësishëm statistikor, që shërben për pasqyrimin e të dhënave lidhur me hetimet paraprake, dinamikën e tyre dhe dërgimin e çështjeve për gjykim, është **evidenca statistikore që Prokurori i Përgjithshëm në mbështetje të nenit 38, pika 2, gërma “h” të Ligjit Nr. 97/2016**

“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, sjell periodikisht në Ministrinë e Drejtësisë dhe që realizohet në zbatim të ligjeve organike të të dyja institucioneve.

Gjatë vitit 2025 me miratimin e Udhëzimit nr. 2, datë 26.06.2025, “Për metodologjinë kombëtare të statistikave të sistemit të drejtësisë”, u mundësua standardizimi dhe harmonizimi i mëtejshëm i të dhënave statistikore të institucioneve të sistemit të drejtësisë, në përputhje me standardet bashkëkohore të raportimit dhe monitorimit institucional. Bazuar në këtë kuadër të ri metodologjik, krahas harmonizimeve terminologjike dhe unifikimit të formateve standarde të raportimit statistikor, u përfshi për herë të parë edhe një grup i zgjeruar treguesish statistikore që lidhen me performancën institucionale, eficiencën e sistemit të drejtësisë, administrimin e burimeve njerëzore, mekanizmat e llogaridhënies, vlerësimin profesional dhe disiplinor të magjistratëve, si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale në sistemin e drejtësisë.

Në funksion të garantimit të zbatimit të unifikuar të kësaj metodologjie dhe shkëmbimit të standardizuar të të dhënave statistikore, Ministria e Drejtësisë nënshkroi më datë 27.04.2026 Marrëveshje Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës, me objekt harmonizimin, zbatimin dhe publikimin e të dhënave statistikore kombëtare të sistemit të drejtësisë.

Përfshirja e këtyre indikatorëve përbën një zhvillim të rëndësishëm në kuadër të statistikave kombëtare të drejtësisë, pasi mundëson një analizë më të plotë, të krahasueshme dhe të bazuar në standardet e Komisionit Evropian për Eficiencën e Drejtësisë (CEPEJ), duke forcuar monitorimin e performancës institucionale dhe mbështetjen e politikave publike të bazuara në evidence.

Gjithashtu, një risi me rëndësi të veçantë në këtë botim përfaqësohet nga përfshirja e një kapitulli të dedikuar mbi të dhënat statistikore dhe veprimtarinë institucionale të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Ky kapitull synon të ofrojë, për herë të parë në mënyrë të strukturuar dhe të integruar, një pasqyrë të plotë mbi funksionimin e mekanizmave të ndihmës juridike falas, duke përfshirë treguesit kryesorë që lidhen me aksesin në drejtësi, kategoritë përfituese, llojet e shërbimeve të ofruara, shpërndarjen gjeografike të përfituesve, si dhe ecurinë e trajtimit të kërkesave për ndihmë juridike parësore dhe dytësore.

Përfshirja e këtij kapitulli kontribuon në rritjen e transparencës institucionale dhe forcimin e monitorimit të efektivitetit të skemës së ndihmës juridike falas, duke mundësuar një vlerësim më të plotë të aksesit të qytetarëve në shërbimet juridike dhe të rolit të këtij mekanizmi në garantimin e së drejtës për akses efektiv në drejtësi, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit mbyll ciklin e grumbullimit të të dhënave për ekzekutimin e vendimeve penale dhe civile, duke plotësuar në tërësi të gjithë lëndën e parë, me të cilën Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave në Ministrinë e Drejtësisë, përpunon dhe analizon të dhënat duke operuar me to për të hartuar informacionin përfundimtar të statistikës së unifikuar, model të cilin po e paraqesim nëpërmjet këtij vjetari.

Vlen të theksohet se informacionet dhe botimet statistikore të INSTAT-it, kanë shërbyer jo vetëm si përvojë dhe metodologji, por edhe si burim informacioni, me të cilat bëhet i mundur përcaktimi i shumë parametrave dinamikë që shprehin fenomene e dukuri specifike të mjediseve heterogjene. Me shumë interes, në këtë kuadër është regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë që jepet nga shfrytëzimi i këtij informacioni për studimin e shpërndarjes së kriminalitetit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile, nëpërmjet përcaktimit të koeficientit të kriminalitetit për çdo rreth gjyqësor, duke u dhënë gjyqtarëve, juristëve, studiuesve dhe institucioneve të drejtësisë, të dhëna të domosdoshme që shërbejnë për politikën penale të dënimit dhe strukturave të tjera që merren me luftën ndaj krimit. Orientim ky për llojin, volumin dhe strukturën e krimit në Shqipëri.

Studimi statistikor i fenomeneve dhe proceseve juridike, ashtu si çdo studim i përgjithshëm statistikor kalon në tri faza:

- 1. Në vrojtimin statistikor;**
- 2. Në përmbledhjen dhe grupimin e të dhënave;**
- 3. Në fazën e përpunimit dhe të analizës.**

“Vrojtim statistikor” është mbledhja e karakteristikave të një popullate të caktuar nëpërmjet kampionimit, për të vlerësuar karakteristikat e saj, bazuar në metodologjinë statistikore. Në këtë kontekst, për lehtësi në kuptimin e materialit përfundimtar që kemi hartuar, sqarojmë se jemi në kushtet e vrojtimit statistikor me zgjedhje, gjë që bën të mundur të mblidhen, grupohen, analizohen dukuritë tipike dhe esenciale, p.sh. llojet e çështjeve penale, paditë dhe kërkesat civile të shqyrtuara, mënyra e përfundimit dhe shpejtësia e gjykimit, politika e dënimit etj., por mund të mos gjenden të dhëna për të gjitha alternativat e dënimit me burgim etj., që në praktikën gjyqësore zbatohen më rrallë. Duke e konsideruar tipiken dhe esencialen në dialektikën e saj, është e mundshme që fenomene të tilla juridike e të tjera si këto të gjejnë dritën e shqyrtimit dhe studimit statistikor për të ardhmen. Përqendrimi i vëmendjes dhe prioriteti i kushtuar ndaj të dhënave statistikore si një nevojë për njohje dhe studime të ndryshme në fushën e drejtësisë në vend, ka bërë të mundur disponimin në një kohë sa më të shpejtë dhe reale të këtyre të dhënave.

Baza e të dhënave shtetërore, publikon në internet në kohë reale disa raporte statistikore nëpërmjet portalit www.gjykata.al.

Informacioni i mundësuar në këtë portal, është i përditësuar me të dhënat më të fundit sipas çështjeve të shqyrtuara dhe vendimeve të dhëna nga gjykatat përkatëse të Shkallës së Parë dhe të Apeleve.

Këto të dhëna mund të përdoren sipas intersit dhe nevojës nga çdo person, grup interesi apo institucion.

Mendimet për përmirësim cilësor dhe sasior të të dhënave do të ishin të mirëpritura.

Në grupimin dhe përmbledhjen e materialit statistikor, jemi përpjekur të bëjmë kujdes në ndarjen e kolektivitetit në grupe homogjene, domethënë bashkimin në grupe (klasa) të së njëjtës gjini e të të njëjtët tip, duke u bazuar në karakteristika të përbashkëta të tyre, si p.sh. ndarjen e çështjeve penale në krime dhe kundërvajtje; ndarjen e çështjeve civile në padi dhe kërkesa, dhe akoma me tej në nënklasa, si: civile në përgjithësi, familjare, administrative, tregtare. Interes paraqet edhe kombinimi i grupimit kualitativ me atë kuantitativ për fenomenet juridike të studiuara. “Besueshmëria”, do të thotë se statistikatat duhet të matin në mënyrë sa më të besueshme, të saktë dhe koherente që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Ajo nënkupton përdorimin e kriterëve shkencorë për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave.

Në Vjetarin Statistikor 2025 janë evidentuar analiza e konkluzione të dukurive të veçanta të shoqëruara me paraqitje, tabelare dhe grafike ose me seri dinamike për rrethe gjyqësore, shkallë të ndryshme të gjyqësorit, gjendjen aktuale të të dënuarve në Instucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, dënimeve alternative, por disa herë jepet edhe material bruto nga i cili mundet të veçohet elementi statistikor për të cilin interesohet përdoruesi i këtij informacioni.

Të gjitha këto të dhëna dhe analiza, janë të përfshira në këtë Vjetar Statistikor në 18 Kapituj kryesorë.

Spektri i përdoruesve të këtij informacioni është i larmishëm nga pikëpamja profesionale.

Ky vjetar shërben për vendimarrje, për qëllime studimore dhe për informim të publikut. Përdoruesit e tij janë autoritetet drejtuese të institucioneve që menaxhojnë problemet e drejtësisë, organizmat e ndryshëm ndërkombëtarë, personalitete të shkencës dhe studentë të Fakultetit të

Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, gazetarë të medias së shkruar dhe audiovizive, si dhe publiku në përgjithësi. Me interes është edhe domosdoshmëria që kanë kryetarët e gjykatave, kancelarët dhe gjyqtarët për njohjen e realitetit të shifrave e fakteve më tej se gjykata e tyre. Në këto kushte, ka qenë e nevojshme pajisja e vjetarit me sqarime për terma të veçantë juridikë dhe statistikorë më të përdorshëm, të cilat janë paraqitur dhe në gjuhën angleze.

Në këtë vjetar, volumin më të madh të materialit statistikor e përbëjnë të dhënat për gjykatat në të gjitha nivelet e tyre, të trajtuara në dy kapituj kryesorë, për çështjet penale, civile dhe administrative në shkallë vendi, si dhe një kapitull për të dhënat analitike të volumit të punës, natyrës së çështjeve të përfunduara dhe modës së tyre për çdo gjykatë të veçantë si dhe gjendjes në burgje dhe paraburgime. Gjithashtu, në këtë vjetar do të gjeni të dhëna për punën e gjykatave për veprat penale në lidhje me Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, pezullimin e vendimeve penale përmes dënimeve alternative, si dhe gjendjen në burgje dhe paraburgime. Informacioni me të dhënat e prokurorisë, përmbartimit, është tepër i domosdoshëm për të plotësuar tërësinë e të dhënave në fushën juridike.

➤ Disa nga konceptet statistikore më të përdorura

Me **“grupim”** kuptojmë ndarjen e masës në grupe homogjene nga pikëpamja cilësore. Grupimi bëhet në klasa, të cilat duhet të përmbajnë tipa të ngjashëm të kolektivitetit në aspektin cilësor dhe si rregull me numër të barabartë elementesh. Për natyrën që ka statistika juridike, ndarja në klasa me numër të njëjtë elementesh është e pamundur, sepse krimet me kundërvajtjet penale që paraqesin ndryshimet cilësore nuk janë në numër të barabartë, gjithashtu kapituj të ndryshëm të Kodit Penal shoqërohen me numër jo të barabartë veprash penale. Për të shmangur këtë “anomali” përdoret koncepti i mesatares aritmetike të ponderuar.

Grupimi mund të jetë kualitativ atëherë kur shprehet me fjalë p.sh. krime, kundërvajtje, çështje familjare, tregtare, administrative etj.

Grupim kuantitativ, atëherë kur shprehet me të dhëna që përmbajnë si p.sh. masën e dënimit, kohëzgjatja e gjykimit, apelimet, rekurset, etj.

“Çështje të mbartura”, quhen ato çështje të cilat në fund të vitit paraardhës (31 Dhjetor) rezultojnë të papërfunduara dhe gjykata i mbart si çështje të vetat në fillim të vitit pasardhës (1 Janar).

“Çështje të përfunduara”, quhen ato çështje të cilat në fund të vitit paraardhës (31 Dhjetor) rezultojnë të përfunduara, për të cilat gjykata është shprehur me një vendim.

“Çështje gjithsej”, quhet kolona e cila në statistikat penale, përmbledh totalin e shifrave të çështjeve të mbartura, të ardhura të reja, të ardhura për rigjykim dhe të ardhura pas rihetimit.

Në statistikat civile dhe administrative, përmbledh totalin e shifrave të çështjeve të mbartura, të ardhura të reja dhe të ardhura pas prishjes nga gjykatat e tjera.

“Modë”, quhet ajo vlerë e zgjedhjes që ka dendurinë më të madhe. E shprehur me fjalë të tjera, moda tregon dukurinë më të shpeshtë në raport me fenomenet e tjera dhe e llogaritur për njësinë e vrojtimit. Në qoftë se të dhënat janë paraqitur në klasa, atëherë klasa me dendurinë më të madhe quhet klasë modale. Mund të ndodhë që të kemi më tepër se një klasë modale; dhe raste të tilla kemi në disa rrethe gjyqësore ku p.sh. moda janë krimet kundër jetës dhe kundër rendit dhe sigurisë publike, si dhe kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

Koeficienti i kriminalitetit, tregon numrin e krimeve për 10 mijë apo 100 mijë banorë. Në këtë rast konkludohet më saktë për shpërndarjen e krimit në vend. Ky parametër shërben për të përcaktuar numrin e krimeve ose veprave penale të konsumuara, duke i vënë këta në raport ideal me numrin e popullsisë së mjedisit shoqëror ku kryhet kjo vepër penale dhe për të cilin është dhënë një vendim përfundimtar. Në rritjen e këtij koeficienti, sidomos për rrethet bregdetare apo kufitare, ndikon edhe eksportimi i krimit.

“Shpërndarja” është vënia në dispozicion e statistikave zyrtare për përdoruesit, pavarësisht nga forma dhe mjetet e përdorura, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.

Vjetarin Statistikor për vitin 2025, do ta gjeni edhe në formë elektronike në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, në adresën: www.drejtesia.gov.al.

Me vendimin nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, Këshilli i Ministrave vendosi që gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dikur gjykatat e rretheve gjyqësore, të ishin vetëm 13 nga 22 që kishin qenë me Dekretin nr. 6201, datë 6.8.2009 të Presidentit të Republikës. Më datë 1 maj 2023, hyri në fuqi riorganizimi i gjykatave duke bërë që, nëntë gjykata të shkriheshin. Kështu, u shkri Gjkata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Mat, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Pukë, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe Gjkata e Rrethit Gjyqësor Krujë. Po ashtu, përmes këtij vendimi, u sanksionua që gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm do të organizoheshin në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin e Tiranës. Gjykatat e apelit pushuan së ekzistuari më datë 1 shkurt 2023, datë në të cilën, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, u vendos në funksion Gjkata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Riorganizimit, sipas vendimit nr 495, datë 21.7.2022, do t’i nënshtroheshin dhe gjykatat administrative të shkallës së parë. Kështu, këto gjykata do të riorganizoheshin në dy gjykata nga gjashtë, që kishin ekzistuar më parë në të gjitha zonat, ku ekzistonin dhe gjykatat e apelit, Të fundit, përta i takon shkrirjes, ishin gjykatat administrative. Këto të fundit u shkrinë më 1.7.2023, ditë në të cilën, filloi punën Gjkata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjkata e Shkallës së Parë Lushnje. Vendimi nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13, të ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave VENDOSI:

1. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm riorganizohen në 13 (trembëdhjetë) gjykata të rretheve gjyqësore me kompetenca tokësore, si më poshtë vijon:

- a) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me seli në qytetin e Beratit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Berat, Dimal, Kuçovë, Skrapar dhe Poliçan;
- b) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me seli në qytetin e Peshkopisë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos;
- c) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me seli në qytetin e Durrësit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Durrës, Shijak, Kavajë dhe Rrogozhinë;
- d) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me seli në qytetin e Elbasanit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd dhe Përrenjas;
- e) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me seli në qytetin e Fierit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnjë, Divjakë dhe Mallakastër;
- f) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me seli në qytetin e Gjirokastrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull;
- g) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me seli në qytetin e Lezhës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin;
- h) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me seli në qytetin e Korçës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Devoll dhe Pogradec;
- i) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me seli në qytetin e Kukësit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Kukës, Has dhe Tropojë;
- j) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me seli në qytetin e Sarandës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë;
- k) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me seli në qytetin e Shkodrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë-Arës;
- l) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Tiranë, Kamzë, Vorë dhe Krujë;
- m) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me seli në qytetin e Vlorës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Vlorë, Selenicë dhe Himarë.

2. Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm riorganizohen në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin e Tiranës.

3. Gjykatat Administrative riorganizohen në 2 (dy) Gjykata Administrative të Shkallës së Parë me kompetenca tokësore, si më poshtë vijon:

- a) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, 2 Elbasan, Lezhë dhe Korçë;
- b) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, me seli në qytetin e Lushnjës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë.

Gjykatat Administrative do të garantojnë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të personave nëpërmjet detyrimit që i vihet organeve publike të provojnë ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes të veprimit

administrativ të nxjerrë prej tyre. Ato do të gjykojnë mbi aktet shkresore dhe mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit.

Ky ligj përcakton rregulla të detyrueshme për:

1. organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative, si dhe statusin e gjyqtarëve që shërbejnë në to;
2. juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave administrative;
3. parimet dhe procedurën e gjykimit, palët në proces dhe personat e tjerë në gjykimin administrativ;
4. vendimet gjyqësore administrative dhe ekzekutimin e tyre.

Përsa i përket kompetencës lëndore, Gjykata Administrative është kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me veprimet administrative, marrëdhëniet e punës të rregulluara nga Kodi i Punës, në të cilat punëdhënësi është një organ publik; si dhe një akt nënligjor normativ të organeve qendrore apo organeve të njëjësive të qeverisjes vendore. Qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative, është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Përmes tyre synohet krijimi i kushteve të përshtatshme për një shqyrtim efektiv duke vënë në vend të drejtat e cënuara nga veprimet dhe/ apo aktet administrative të nxjerra nga organet publike.

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri i është nënshtruar së fundmi një sërë reformash të thella, në funksion të përmbushjes së standarteve evropiane në këtë sistem. Përmes miratimit të Ligjit nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, Shqipëria krijoi bazën për zbatimin e reformës në drejtësi. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve organike të miratuara në kuadrin e reformës së drejtësisë përmbajnë dispozita të përcaktuara qartë që garantojnë pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin, integritetin e sistemit gjyqësor, si dhe përmirësimin e mekanizmave llogaridhënës dhe monitorues të funksionimit të saj. Reforma në drejtësi ka sjellë ndryshime të rëndësishme në përcaktimet institucionale të gjyqësorit shqiptar. Institucionet e reja janë krijuar nga amendamentet kushtetuese dhe ligjet specifike organike të lartpërmendura.

Në muajin dhjetor 2019, në zbatim të Vendimit Nr. 286, dt.18.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (Vendimi filloi efektet më datë 19.12.2019). Konkretisht, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

KREU I


❖ STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET PENALE DHE ÇËSHTJET CIVILE TË GJYKUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE DHE ÇËSHTJET CIVILE TË GJYKUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, GJPKKO DHE GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË

Gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar gjithsej **55,413** çështje penale dhe civile nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, nga **63,812** çështje penale dhe civile që janë shqyrtuar në 2024, nga **56,522** çështje penale dhe civile që janë shqyrtuar në 2023, nga **76,417** çështje penale dhe civile që janë shqyrtuar në 2022, nga **82,304** çështje penale dhe civile që janë shqyrtuar në vitin 2021, si dhe nga **46,669** çështje penale dhe civile që janë shqyrtuar në vitin 2020.


Në mënyrë tabelare dhe grafike kemi panoramën si më poshtë:

Periudha (Period)	Çështje penale të përfunduara (Criminal cases)	Çështje civile të përfunduara (Civil cases)	Gjithsej (Total)
Viti 2020	9,791	36,878	46,669
Viti 2021	11,791	70,513	82,304
Viti 2022	10,490	65,927	76,417
Viti 2023	9,313	47,209	56,522
Viti 2024	10,486	53,326	63,812
Viti 2025	9,843	45,570	55,413




**STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE DHE ÇËSHTJET CIVILE TË REGJISTRUARA
NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM,
GJPKKO DHE GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË PËR VITIN 2025**

Gjykatat e Shkallës së Parë (First instance courts)	Gjithsej të regjistruara (Total registered)	Penale të regjistruara (Penal cases registered)	Civile të regjistruara (Civil cases registered)
Berat	2,425	496	1,929
Dibër	1,251	313	938
Durrës	7,113	1,662	5,451
Elbasan	4,626	1,001	3,625
Fier	4,651	1,145	3,506
Gjirokastrë	2,002	553	1,449
Korçë	3,341	963	2,378
Kukës	1,019	335	684
Lezhë	2,978	670	2,308
Sarandë	2,045	351	1,694
Shkodër	3,195	932	2,263
Tiranë	33,585	4,037	29,548
Vlorë	4,248	725	3,523
GJPKKO	161	161	-
Adm.Tiranë	17,852	-	17,852
Adm.Lushnjë	3,769	-	3,769
T O T A L I	94,261	13,344	80,917



**STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE DHE ÇËSHTJET CIVILE TË GJYKUARA
NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM,
GJPKKO DHE GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË PËR VITIN
2025**

Gjykatat e Shkallës së Parë (First instance courts)	Gjithsej të Përfunduara (Total examined)	Përfunduar Penale (Penal cases examined)	Përfunduar Civile (Civil cases examined)
Berat	1,637	412	1,225
Dibër	917	258	659
Durrës	4,453	1,182	3,271
Elbasan	2,619	684	1,935
Fier	2,506	930	1,576
Gjirokastrë	971	299	672
Korçë	1,861	675	1,186
Kukës	756	269	487
Lezhë	2,115	509	1,606
Sarandë	1,344	290	1,054
Shkodër	1,932	762	1,170
Tiranë	18,648	2,863	15,785
Vlorë	2,747	628	2,119
GJPKKO	82	82	-
Adm.Tiranë	10,643	-	10,643
Adm.Lushnjë	2,182	-	2,182
T O T A L I	55,413	9,843	45,570




STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE TË GJYKUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, TË SHPREHURA NË PËRQINDJE

Gjatë vitit **2025** janë regjistruar në total **13,364** çështje penale nga të cilat **13,364** çështje penale sipas Kodit Penal dhe **20** çështje penale sipas Kodit Penal Ushtarak.

Kanë përfunduar **9,861** çështje penale, ku **9,843** sipas Kodit Penal dhe **18** sipas Kodit Penal Ushtarak dhe kanë mbetur pa përfunduar **3,503** çështje penale, nga të cilat **3,501** sipas KP dhe **2** sipas KPU.

Periudha (Period)	Çështje penale (Criminal cases)	Përqindja (Percentage)
Viti 2021	14,945	25%
Viti 2022	14,154	24%
Viti 2023	9,313	16%
Viti 2024	10,486	18%
Viti 2025	9,843	17%

Çështje Penale të përfunduara 2025



DINAMIKA E ÇËSHTJEVE PENALE 2025

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe GJPKKO (First Instance Courts of General Jurisdiction and Special Court)	Çështje të mbartura (Pending cases)	Ardhur të reja (New cases)	Ardhur pas prishjes (Cases to be retried)	Ardhur pas ri hetimit (Cases to be re-investigated)	Gjithsej (Total)
Berat	113	383	-	-	496
Dibër	45	268	-	-	313
Durrës	433	1,227	2	-	1,662
Elbasan	394	607	-	-	1,001
Fier	165	979	1	-	1,145
Gjirokastrë	336	217	-	-	553
Korçë	189	774	-	-	963
Kukës	72	263	-	-	335
Lezhë	138	532	-	-	670
Sarandë	64	287	-	-	351
Shkodër	175	754	2	1	932
Tiranë	762	3,266	9	-	4,037
Vlorë	169	556	-	-	725
GJPKKO	59	102	-	-	161
T O T A L I	3,114	10,215	14	1	13,344

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe GJPKKO (First Instance Courts of General Jurisdiction and Special Court)	Me vendim Fajësie (By plea of guilty)	Me vendim Pafajësie (By plea of not guilty)	Çështje të Pushuar a (Ceased cases)	Kthyer për plotësim hetimesh (Cases to be reinvestigated)	Vendosur in kompetenca (Lack of competence)	SHUMA (Total)
Berat	363	25	21	3	0	412
Dibër	238	2	17	1	0	258
Durrës	1,095	40	41	6	0	1182
Elbasan	649	5	23	5	2	684
Fier	835	48	47	0	0	930
Gjirokastrë	238	25	36	0	0	299
Korçë	592	25	50	7	1	675
Kukës	219	11	29	8	2	269
Lezhë	471	16	22	0	0	509
Sarandë	249	16	17	8	0	290
Shkodër	726	9	26	1	0	762
Tiranë	2,641	114	107	0	1	2863
Vlorë	571	34	22	1	0	628
GJPKKO	68	6	4	2	2	82
T O T A L I	8,955	376	462	42	8	9,843

ÇËSHTJET PENALE SIPAS GJYKATAVE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe GJPKKO (First Instance Courts of General Jurisdiction and Special Court)	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Berat	496	412	84
Dibër	313	258	55
Durrës	1,662	1,182	480
Elbasan	1,001	684	317
Fier	1,145	930	215
Gjirokastrë	553	299	254
Korçë	963	675	288
Kukës	335	269	66
Lezhë	670	509	161
Sarandë	351	290	61
Shkodër	932	762	170
Tiranë	4,037	2,863	1,174
Vlorë	725	628	97
GJPKKO	161	82	79
T O T A L I	13,344	9,843	3,501

**NDARJA E ÇËSHTJEVE PENALE NË KRIME DHE NË KUNDËRVAJTJE PENALE TË
GJYKUARA NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM DHE GJPKKO PËR VITIN 2025**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe GJPKKO (First Instance Courts of General Jurisdiction and Special Court)	Përfunduar penale (Penal cases examined)	Përfunduar krime (Examined crime offenses)	Përfunduar kundërvajtje penale (Examined Contraventions)
Berat	412	320	92
Dibër	258	182	76
Durrës	1,182	1,114	68
Elbasan	684	549	135
Fier	930	824	106
Gjirokastrë	299	199	100
Korçë	675	494	181
Kukës	269	217	52
Lezhë	509	451	58
Sarandë	290	235	55
Shkodër	762	640	122
Tiranë	2,863	2,541	322
Vlorë	628	568	60
GJPKKO	82	71	11
TOTALI	9,843	8,405	1,438

ÇËSHTJE PENALE GJITHSEJ TË GJYKUARA PËR VITIN 2025

Të dhënat e mëposhtme paraqesin volumin e punës së Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke përfshirë çështjet penale dhe çështjet penale ushtarake si vijon:


Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe GJPKKO (First Instance Courts of General Jurisdiction and Special Court)	Përfunduar penale (Terminated cases)	Përfunduar çështjet ushtarake (Terminated military criminal cases)	Përfunduar Gjithsej (Terminated cases)
Berat	412	12	424
Dibër	258		258
Durrës	1,182	1	1,183
Elbasan	684		684
Fier	930	3	933
Gjirokastrë	299		299
Korçë	675		675
Kukës	269		269
Lezhë	509		509
Sarandë	290		290
Shkodër	762		762
Tiranë	2,863	1	2,864
Vlorë	628	1	629
GJPKKO	82		82
T O T A L I	9,843	18	9,861

SERIA DINAMIKE E KËRKESAVE PENALE SIPAS GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Për vitin 2025 numri i kërkesave penale është 18,840. Vihet re një rritje me 162 kërkesa më shumë në krahasim me kërkesat penale të vitit 2024, ku gjithsej janë regjistruar 18,678 kërkesa. Kërkesat penale në 2025 kanë pësuar rritje në krahasim me kërkesat penale të vitit 2023 ku ka pasur 16,595 konkretisht 2,245 kërkesa penale më shumë. Në krahasim me vitin 2022 ku ka pasur 17,880 kërkesa

vihen re 960 kërkesa më shumë. Rënia në kërkesat penale në 2025, me një diferencë prej 2,665 kërkesash penale më pak, vihet re në krahasim me vitin 2021 ku ka pasur 20,443 kërkesa. Po ti referohemi vitit 2020 me një total prej 20,443 kërkesash penale, do të vihet re një ulje e kërkesave penale në vitin 2025, me 1,603 kërkesa penale më pak.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe GJPKKO (First Instance Courts of General Jurisdiction and Special Court)	Gjithsej kërkesa penale (A total of criminal requests)
Berat	627
Dibër	467
Durrës	3,027
Elbasan	1,595
Fier	2,155
Gjirokastrë	491
Korçë	1,208
Kukës	236
Lezhë	1,489
Sarandë	536
Shkodër	1,754
Tiranë	1,719
Vlorë	741
GJPKKO	2,795
T O T A L I	18,840




SHPEJTËSIA E GJYKIMIT PËR ÇËSHTJET PENALE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe GJPKKO (First Instance Courts of General Jurisdiction and Special Court)	AFATET (Term of termination)			
	0-6 muaj (0-6 months)	6 muaj-1 vit (6 months-1 year)	1 - 2 vjet (1-2 year)	Mbi 2 vjet (Over 2 year)
Berat	347	24	22	19
Dibër	214	6	35	3
Durrës	900	244	33	5
Elbasan	434	179	51	20
Fier	860	38	17	15
Gjirokastrë	241	58	0	0
Korçë	595	39	19	22
Kukës	231	18	10	10
Lezhë	421	44	29	15
Sarandë	238	26	14	12
Shkodër	702	44	9	7
Tiranë	2378	407	56	22
Vlorë	543	39	30	16
GJPKKO	50	17	9	6
T O T A L I	8,154	1,183	334	172

VOLUMI I PUNES PËR 8 VITET E FUNDIT PËR ÇËSHTJET PENALE


Nga tabela e mëposhtme vëmë re se volumi i punës për tetë (8) vitet e fundit (2018-2025), për çështjet penale (duke mos përfshirë çështjet penale ushtarake) ka pësuar ndryshime. Në vitin 2025 çështjet penale kanë pësuar ulje prej **643** çështjesh në krahasim me vitin 2024 dhe **530** çështje më shumë se në vitin 2023. Për vitin 2025, në krahasim me vitin 2022, volumi i punës ka pësuar ulje me **647** çështje penale të përfunduara, krahasuar me vitin 2021 volumi i punës ka pësuar ulje me **1,948** çështje penale të përfunduara më pak. Ndërkohë, volumi i punës ka pësuar rritje të çështjeve penale të përfunduara me **52** çështje më shumë se në vitin 2020. Krahasuar me vitin 2019, volumi i punës ka pësuar rënie me **1,688** çështje çështje më pak. Krahasuar me vitin 2018, volumi i punës ka pësuar rënie me **3,984** çështje çështje më pak.

Çështjet Penale (Criminal cases)	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Çështjet Penale të përfunduara	13,827	11,531	9,791	11,791	10,490	9,313	10,486	9,843



KRAHASIMI I DINAMIKËS SË ÇËSHTJEVE PENALE PËR 8 VITET E FUNDIT

Periudha (Period)	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Gjithsej me ushtaraket (Total)	16,927	14,990	16,963	14,990	13,856	12,686	14,179	13,364
Përfunduar (Examined)	13,866	11,827	9,821	11,827	10,518	9,361	10,507	9,861
Pa përfunduar (Pending)	3,061	3,163	7,142	3,163	3,338	3,325	3,672	3,503



Në tabelën dhe garfikun e mësipërm përfshihet dinamika e numrit të çështjeve penale dhe çështjeve penale ushtarake.

KREU II

❖ **KLASIFIKIMI I ÇËSHTJEVE PENALE
DHE
ANKIMIMET**

KLASIFIKIMI I ÇËSHTJEVE PENALE DHE ANKIMIMET

Nga **9,861** çështje penale të përfunduara në vitin 2025, janë gjykuar **9,843** çështje penale sipas Kodit Penal dhe sipas Kodit Penal Ushtarak **18** çështje penale.

Në vijim po analizojmë çështjet e gjykuara sipas Kodit Penal, sepse çështjet e gjykuara sipas Kodit Penal Ushtarak trajtohen në një kapitull të veçantë.

Ndër çështjet e gjykuara sipas Kodit Penal, nga **9,843** gjithsej, çështje të përfunduara për krime janë **8,405** dhe ato për kundërvajtje janë **1,438**. Në tërësi, krimet zënë **85.4%** të veprave penale, ndërsa kundërvajtjet **14.6%** të tyre. Në këto të dhëna nuk merren në konsideratë rastet kur në një çështje penale janë konsumuar më shumë sesa një vepër penale.

Kërkesa penale, ku përfshihen kryesisht masat e sigurimit dhe të gjitha kërkesat e tjera të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, dhe që përbëjnë volumnin e punës për gjykatat e shkallës së parë për vitin 2025, janë **18,840** kërkesa penale.

Nga **18,840** kërkesa penale gjithsej, **2,570** janë masë sigurimi arrest me burg, **775** janë masë sigurimi arrest shtëpie, **2,421** janë masë sigurimi detyrim paraqitjeje, **46** janë masë sigurimi arrest në mungesë, mjekim i detyruar **99**, rivlerësim i masës së sigurimit **235** kërkesa, **47** janë masa për vendosjen e garancisë pasurore, vendosja në mbikëqyrje e të miturit **1**, kërkesa për njohje të vendimeve penale të huaja **7** dhe **12,639** janë kërkesa të tjera penale.

Numrin më të madh të kërkesave penale në shkallë vendi e zë Gjykata e Posaçme Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar me 2,664 kërkesa penale.

Gjeografia e çështjeve penale të përfunduara është e larmishme, duke përfshirë çështje nga të gjithë kapitujt e Kodit Penal, por denduria dhe intensiteti i tyre është disproporcional.

Kështu, po të analizojmë disa nga të dhënat e çështjeve penale të përfunduara sipas kapitujve apo grupveprash penale, gjendja paraqitet si më poshtë:

- Krime kundër njerëzimit, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **0** çështje.
- Vepra penale kundër personit (Krime kundër jetës), të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **88** çështje.
- Vepra penale kundër shëndetit, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **71** çështje
- Krime seksuale, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **69** çështje .
- Vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **29** çështje .
- Krime kundër moralit, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **122** çështje .

- ❑ Krime kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **963** çështje .
- ❑ Krime kundër lirisë së besimit, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **0** çështje .
- ❑ Vepra penale kundër pasurisë, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **2,191** çështje .
- ❑ Vepra penale kundër mjedisit, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **8** çështje.
- ❑ Krime kundër pavarësisë dhe rendit Kushtetues, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **0** çështje.
- ❑ Krime që çënojnë marrdhëniet, të parashikuar në Kodin Penal në kanë përfunduar **0** çështje.
- ❑ Aktet terroriste, të parashikuar në Kodin Penal ka përfunduar **2** çështje.
- ❑ Krimet kundër autoritetit të shtetit dhe veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, të parashikuar në Kodin Penal kanë **4,556** çështje të përfunduara.
- ❑ Krimet kundër drejtësisë, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **283** çështje.
- ❑ Vepra penale që prekin zgjedhjet, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **11** çështje.
- ❑ Krime të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale, të parashikuar në Kodin Penal kanë përfunduar **5** çështje.

Nga analiza e këtyre të dhënave konkludohet se, përsa i përket sasisë së çështjeve penale të përfunduara, **moda** është klasa e çështjeve penale që përfshijnë krime shtetit, të cilat totalisht përbëjnë **4,556** çështje penale ose **54.2 %** të të gjitha krimeve të gjykuara në vend.

Për vitin 2025 intensiteti i çështjeve të përfunduara për krime kundër shtetit është ulur në 4,556 çështje, pra 151 çështje më pak se në vitin 2024.

Nga **9,843** çështje penale të përfunduara sipas Kodit Penal, janë ankimuar **1,438** çështje në apel që përbejnë **14.6%** të tyre. Nga ankimimet në **290** raste kemi apel të prokurorit dhe në **1,148** kemi apel të të pandehurit, duke marrë në konsideratë që për të njëjtën vepër mund të ketë bërë ankim edhe i pandehuri edhe prokurori. Rezulton se kemi gjithsej **3** rekurse nga i pandehuri. Në total për vitin 2025, apeline dhe rekurse janë regjistruar **1,441**.

SERITË DINAMIKE QË TREGOJNË ANKIMIMET NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Gjykata (Court)	ANKIMIME (Complaints)							
	Apelim i prokurorit (Prosecutor' s appeal)	Apelim i të pandehurit (Defendant' s appeal)	Çështje të apeluara (Appeale d cases)	Rekursi i prokurorit (Prosecutor' s recourse)	Rekursi i pandehurit (Defendant' s recourse)	Gjithsej rekurse (A total of recourses)	Gjithsej ankime (A total of complaints)	
	Berat	5	26	31	0	0	0	31
	Dibër	18	68	86	0	0	0	86
Durrës	86	205	291	0	0	0	291	
Elbasan	0	0	0	0	0	0	0	
Fier	5	119	124	0	3	3	127	
Gjirokastrë	15	19	34	0	0	0	34	
Korçë	7	31	38	0	0	0	38	
Kukës	9	60	69	0	0	0	69	
Lezhë	0	0	0	0	0	0	0	
Sarandë	2	44	46	0	0	0	46	
Shkodër	43	250	293	0	0	0	293	
Tiranë	85	252	337	0	0	0	337	
Vlorë	15	74	89	0	0	0	89	
GJPKKO	0	0	0	0	0	0	0	
T O T A L I	290	1,148	1,438	0	3	3	1,441	


Në analizën e kësaj tablele duhet të merret parasysh fakti që për një çështje mund të kenë bërë apel ose rekurs edhe i pandehuri edhe prokurori.

APELIMET

Në vitin 2025 numri i çështjeve të apeluara ka qenë **1,438** çështje penale. Në vitin 2024 numri i çështjeve të apeluara ka qenë **1,228** çështje penale. Në vitin 2023 numri i çështjeve të apeluara ka qenë **1,273** çështje penale. Në vitin 2022, numri i çështjeve të apeluara ka qenë **2,042**. Në vitin 2021, numri i çështjeve të apeluara ka qenë **3,334** dhe në vitin 2020 numri i çështjeve të apeluara ka qenë **2,818** çështje penale.

Krahasuar me të dhënat për apelimet e vitit të mëparshëm, kemi një ulje të çështjeve penale të apeluara. Në vitin **2025** ka pasur një rrite prej **210** ankimime penale në krahasim me vitin 2024; **163** ankimime më shumë se sa në vitin 2023; **604** më pak ankimime krahasuar me vitin 2022; **1,896** më pak ankimime krahasuar me vitin 2021. Krahasuar me vitin 2020, rezulton se janë regjistruar **1,380** ankimime më pak .

Periudha (Period)	Apelime gjithsej (A total of appeals)	Apeli i prokurorit (Prosecutor's appeal)	Apeli i të pandehurit (Defendant's appeal)
Viti 2020	2,818	614	2,253
Viti 2021	3,334	515	2,839
Viti 2022	2,042	332	1,706
Viti 2023	1,273	313	960
Viti 2024	1,228	245	983
Viti 2025	1,438	290	1148




REKURSE TË DREJTËPËRDREJTA

Për vitin 2022 nga Gjykatat e Shkallës së Parë janë shpallur të pafajshëm 8 persona dhe janë dënuar 208 persona, ndërkohë që nga Gjykatat e Apelit janë shpallur të pafajshëm 21 persona dhe janë dënuar 176 persona. Nga Gjykata e Lartë janë shpallur të pafajshëm 2 persona dhe janë dënuar 51 persona, Të gjitha çështjet janë shqyrtuar në dhomë Këshillimi nga Gjykata e Lartë.

Për vitin 2023 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm janë shpallur të pafajshëm 20 persona dhe janë dënuar 288 persona, ndërkohë që nga Gjykata e Apelit janë shpallur të pafajshëm 16 persona dhe janë dënuar 111 persona. Nga Gjykata e Lartë janë shpallur të

pafajshëm 2 persona dhe janë dënuar 8 persona, Të gjitha çështjet janë shqyrtuar në dhomë Këshillimi nga Gjykata e Lartë.

Për vitin 2024 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridksionit të Përgjithshëm janë shpallur të pafajshëm 17 persona dhe janë dënuar 174 persona, ndërkohë që nga Gjykata e Apelit janë shpallur të pafajshëm 13 persona dhe janë dënuar 83 persona. Nga Gjykata e Lartë janë shpallur të pafajshëm 3 persona dhe janë dënuar 11 persona, Të gjitha çështjet janë shqyrtuar në dhomë Këshillimi nga Gjykata e Lartë.

Për vitin 2025 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridksionit të Përgjithshëm janë shpallur të pafajshëm 13 persona dhe janë dënuar 197 persona, ndërkohë që nga Gjykata e Apelit janë shpallur të pafajshëm 48 persona dhe janë dënuar 160 persona. Nga Gjykata e Lartë janë shpallur të pafajshëm 2 persona dhe janë dënuar 40 persona, Të gjitha çështjet janë shqyrtuar në dhomë Këshillimi nga Gjykata e Lartë.

Krahasimi në përqindje për pesë vitet e fundit për personat e dënuar në lidhje me veprat penale të Korrupsionit, është si më poshtë:

Në vitin 2021 janë dënuar 235 persona në shkallën e parë të gjykimit (një ulje prej 16 % në vitin 2025).

Në vitin 2022 janë dënuar 208 persona në shkallën e parë të gjykimit (një ulje prej 5 % në vitin 2023).

Në vitin 2023 janë dënuar 288 persona në shkallën e parë të gjykimit. (një ulje prej 32 % në vitin 2023).



Në vitin 2024 janë dënuar 174 persona në shkallën e parë të gjykimit (një rritje prej 13 % në vitin 2023).

Në vitin 2025 janë dënuar 197 persona në shkallën e parë të gjykimit.

Në shkallën e dytë të gjykimit, rezulton se në vitin 2020 janë dënuar 87 persona (një rritje prej 84 % në vitin 2025), në vitin 2021 janë dënuar 99 persona (një rritje prej 38 % në vitin 2025), në vitin 2022 janë dënuar 176 persona (një ulje prej 9 % në vitin 2025), vitin 2023 janë dënuar 111 persona (një rritje prej 44 % në vitin 2025), në vitin 2024 janë dënuar 83 persona (një rritje prej 93 % në vitin 2025) dhe në vitin 2025 janë dënuar 160 persona.

Në Gjykatën e Lartë janë shpallur të pafajshëm 2 persona dhe janë dënuar 40 persona.

Në grafikët e mëposhtëm, përfshihen dinamikat e numrit personat e pafajshëm dhe të personave të dënuar nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Apelit të Juridksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata e Lartë, për veprat penale në lidhje me **Korrupsionin** për vitin 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe vitin 2025.



Çështjet e shqyrtuara nga gjykatat për veprat penale të Krimit të Organizuar

Lufta kundër krimit të rëndë e atij të organizuar, përbën tashmë një fazë të rëndësishme të zhvillimit shoqëror të shoqërisë shqiptare e sistemit të drejtësisë në veçanti. Lufta ndaj krimit të organizuar dhe krimeve të rënda përbën një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare, si dhe është një ndër kriteret kryesore për procesin e anëtarësimit të vendit në BE.

Për vitin 2015, nga ana e ekspertëve të Delegacionit të BE, është bërë ndryshimi i tabelës së matjeve të rritjes së luftës kundër Krimit të Organizuar dhe në vend të personave të gjykuar, është kërkuar numri i personave të shpallur të pafajshëm nga ana e Gjykatave në shkallë vendi për këto vepra penale.

Në Qershor të vitit 2016, u nënshkrua Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Integritimit Europian "Për harmonizimin e të dhënave statistikore dhe raportimin e ecurisë së gjykimit të çështjeve gjyqësore penale që lidhen me veprat penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar".

Për vitin 2019, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë **9** persona dhe janë dënuar **268** persona, ndërkohë që nga Gjykatat e Apeleve janë shpallur të pafajshëm **14** persona dhe janë dënuar **353** persona. Në Gjykatën e Lartë janë shpallur të pafajshëm **0** persona dhe janë dënuar **0** persona. Në këtë vit, nga këto të dhëna konstatohet një trend në rritje të dënimit të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale të Krimit të Organizuar në **Gjykatat e Shkallës së Parë**.

Për vitin 2020, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë **4** persona dhe janë dënuar **223** persona, ndërkohë që nga Gjykatat e Apeleve janë shpallur të pafajshëm **12** persona dhe janë dënuar **267** persona. Në Gjykatën e Lartë janë shpallur të pafajshëm **0** persona dhe janë dënuar **0** persona. Në këtë vit, nga këto të dhëna konstatohet një ulje të dënimit të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale të Krimit të Organizuar në **Gjykatat e Shkallës së Parë dhe në Gjykatat e Apelit**.

Për vitin 2021, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë **3** persona dhe janë dënuar **302** persona, ndërkohë që nga Gjykatat e Apeleve janë shpallur të pafajshëm **5** persona dhe janë dënuar **381** persona. Në Gjykatën e Lartë janë shpallur të pafajshëm **0** persona dhe janë dënuar **0** persona. Në këtë vit, nga këto të dhëna konstatohet një rritje të dënimit të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale të Krimit të Organizuar në **Gjykatat e Shkallës së Parë dhe në Gjykatat e Apelit**.

Për vitin 2022, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë **4** persona dhe janë dënuar **309** persona, ndërkohë që nga Gjykatat e Apeleve janë shpallur të pafajshëm **15** persona dhe janë dënuar **562** persona. Në Gjykatën e Lartë janë shpallur të pafajshëm **1** persona dhe janë dënuar **41** persona. Në këtë vit, nga këto të dhëna konstatohet një rritje të dënimit të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale të Krimit të Organizuar në **Gjykatat e Shkallës së Parë, në Gjykatat e Apelit, si dhe në Gjykatën Lartë**.

Për vitin 2023, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **21** persona dhe janë dënuar **269** persona, ndërkohë që nga Gjykata e Apelit janë shpallur të pafajshëm **9** persona dhe janë dënuar **766** persona. Në Gjykatën e Lartë janë shpallur të pafajshëm **0** persona dhe janë dënuar **13** persona. Në këtë vit, nga këto të dhëna konstatohet një rritje të dënimit të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale të Krimit të Organizuar në **në**

Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm por një ulje në **Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Lartë**.

Për vitin 2024, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **6** persona dhe janë dënuar **322** persona, ndërkohë që nga Gjykata e Apelit janë shpallur të pafajshëm **8** persona dhe janë dënuar **1107** persona. Në Gjykatën e Lartë janë shpallur të pafajshëm **0** persona dhe janë dënuar **15** persona. Në këtë vit, nga këto të dhëna konstatohet një rritje të dënimit të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale të Krimin të Organizuar në **Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Lartë**.

Për vitin 2025, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **9** persona dhe janë dënuar **207** persona, ndërkohë që nga Gjykata e Apelit janë shpallur të pafajshëm **26** persona dhe janë dënuar **1121** persona. Në Gjykatën e Lartë janë shpallur të pafajshëm **3** persona dhe janë dënuar **112** persona. Në këtë vit, nga këto të dhëna konstatohet një rritje të dënimit të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale të Krimin të Organizuar në **Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Lartë**.

Duke parë shifrat e të dhënave statistikore të këtyre viteve, vëmë re se lufta ndaj Krimin të Organizuar është në vëmendje të organeve të Drejtësisë edhe pse vihet re një **rritje e numrit të personave të shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata e Lartë**.

Krahasimi në përqindje për pesë vitet e fundit për personat e dënuar në lidhje me veprat penale të Krimin të Organizuar, është si më poshtë:

Në vitin 2021 janë dënuar **302** persona në shkallën e parë të gjykimit (një ulje prej **31 %** në vitin 2025).

Në vitin 2022 janë dënuar **309** persona në shkallën e parë të gjykimit (një ulje prej **33 %** në vitin 2025).

Në vitin 2023 janë dënuar **269** persona në shkallën e parë të gjykimit (një ulje prej **23 %** në vitin 2025).



Në vitin 2024 janë dënuar **322** persona në shkallën e parë të gjykimit (një ulje prej **36 %** në vitin 2025).

Në vitin 2025 janë dënuar **207** persona në shkallën e parë të gjykimit.

Në shkallën e dytë të gjykimit, rezulton se në vitin 2020 janë dënuar **267** persona (një rritje prej **320 %** në vitin 2025), në vitin 2021 janë dënuar **381** persona (një rritje prej **194 %** në vitin 2025), në vitin 2022 janë dënuar **562** persona (një rritje prej **99 %** në vitin 2025), në vitin 2023 janë dënuar **766** persona (një rritje prej **46 %** në vitin 2025), në vitin 2024 janë dënuar **1107** persona (një rritje prej **1 %** në vitin 2025) dhe në vitin **2025** janë dënuar **1121** persona.

Në Gjykatën e Lartë janë shpallur të pafajshëm **3** persona dhe janë dënuar **112** persona.

Në grafikët e mëposhtëm, përfshihen dinamikat e numrit personat e pafajshëm dhe të personave të dënuar nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata e Lartë, për veprat penale në lidhje me **Krimin e Organizuar** për vitin 2021, 2022, 2023, 2024 dhe vitin 2025.





Në rastin e gjyqimeve dhe dënimeve, vihet re një ulje në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 për veprat penale në lidhje me Krimin e Organizuar nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për veprat penale në lidhje me Krimin e Organizuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vihet re një rritje e lehtë në rastin e gjyqimeve dhe dënimeve në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 por ruhen shifra të konsiderueshme për këto të dhëna krahasuar me vitet e kaluara.

Për veprat penale në lidhje me Korrupsionin, vihet re një rritje e ndjeshme në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nga Gjykata e Lartë.


Të dhënat e grupuara në mënyrën tabelare dhe grafike për Grup-Veprat Penale në lidhje me korrupsionin, krimin e organizuar dhe krimet e rënda në vitin 2025, paraqiten si vijon:

Grup-Veprat Penale në lidhje me korrupsionin, krimin e organizuar dhe krimet e rënda (Criminal offences related to corruption, organized crime and serious crimes)	Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (First Instance Courts of General Jurisdiction)		Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (Appeal Court of General Jurisdiction)		Gjykata e Lartë (Supreme Court)	
	Numri i personave të shpallur të pafajshëm (No. of people acquitted)	Nr. personave të denuar (No. of convicted persons)	Numri i personave të shpallur të pafajshëm (No. of people acquitted)	Nr. personave të denuar (No. of convicted persons)	Numri i personave të shpallur të pafajshëm (No. of people acquitted)	Nr. personave të denuar (No. of convicted persons)
KORRUPSIONI	13	197	48	160	2	40
Grupi 1: Korrupsioni në sektorin publik	12	93	30	69	0	16
Neni 135	1	16	2	10	0	0
Neni 244	0	57	5	3	0	4
Neni 244/a	0	0	0	0	0	0
Neni 245/1	0	0	2	0	0	6
Neni 248	11	18	21	53	0	2
Neni 256	0	0	0	0	0	0
Neni 258	0	0	0	0	0	0
Neni 259	0	2	0	3	0	4
Neni 259/a	0	0	0	0	0	0
Grupi 2: Konflikti i interesave dhe deklarimi i pasurisë	0	0	1	0	0	0
Neni 257	0	0	0	0	0	0
Neni 257/a	0	0	1	0	0	0
Grupi 3: Korrupsioni i nivelit të lartë	0	0	2	1	0	4
Neni 245	0	0	2	1	0	4
Neni 260	0	0	0	0	0	0
Grupi 4: Korrupsioni në Sistemin Gjyqësor	0	0	0	0	0	0
Neni 312	0	0	0	0	0	0
Neni 319	0	0	0	0	0	0
Neni 319/a	0	0	0	0	0	0
Neni 319/b	0	0	0	0	0	0
Neni 319/c	0	0	0	0	0	0
Neni 319/ç	0	0	0	0	0	0
Neni 319/d	0	0	0	0	0	0
Neni 319/dh	0	0	0	0	0	0
Neni 319/e	0	0	0	0	0	0


Grupi 5: Korrupsioni në sektorin privat	0	0	0	0	1	0
Neni 164	0	0	0	0	1	0
Neni 164/a	0	0	0	0	0	0
Grupi 5: Falsifikimi	1	104	15	90	1	20
Neni 186	0	35	10	56	1	11
Neni 186/a	1	4	0	4	0	0
Neni 189	0	53	0	18	0	0
Neni 190	0	12	5	12	0	9
KRIMI I ORGANIZUAR DHE KRIMET E RENDA	9	207	26	1121	3	112
Grupi 1: Trafikimi i qënieve njerëzore	0	1	4	79	0	1
Neni 109	0	0	2	29	0	0
Neni 109/b	0	1	2	18	0	1
Neni 110/a	0	0	0	27	0	0
Neni 128/b	0	0	0	5	0	0
Grupi 2: Trafikimi i veprave të artit, kulturës dhe mjeteve motorike	0	4	1	7	0	0
Neni 138/a	0	0	0	2	0	0
Neni 141/a	0	4	1	5	0	0
Grupi 3: Kontrabanda	0	0	3	5	0	0
Neni 175	0	0	3	5	0	0
Neni 176	0	0	0	0	0	0
Grupi 4: Falsifikimi i parave	0	4	0	5	0	0
Neni 183	0	4	0	5	0	0
Neni 184	0	0	0	0	0	0
Grupi 5: Trafikimi i armëve	0	1	0	3	0	0
Neni 278/a	0	1	0	2	0	0
Neni 282/a	0	0	0	1	0	0
Grupi 6: Trafikimi i lëndëve narkotike	4	133	11	926	0	24
Neni 283	2	108	8	771	0	19
Neni 283/a	2	10	0	36	0	5
Neni 284	0	15	3	119	0	0
Neni 284/a	0	0	0	0	0	0
Neni 284/c	0	0	0	0	0	0
Neni 284/ç	0	0	0	0	0	0

Grupi 7: Pastrimi i parave	2	7	3	29	0	5
Neni 287	2	3	3	20	0	5
Neni 287/b	0	4	0	9	0	0
Grupi 8: Terrorizmi	0	0	0	0	0	0
Neni 111	0	0	0	0	0	0
Neni 230	0	0	0	0	0	0
Neni 230/a	0	0	0	0	0	0
Neni 230/b	0	0	0	0	0	0
Neni 230/c	0	0	0	0	0	0
Neni 230/ç	0	0	0	0	0	0
Neni 230/d	0	0	0	0	0	0
Neni 231	0	0	0	0	0	0
Neni 232	0	0	0	0	0	0
Neni 232/a	0	0	0	0	0	0
Neni 232/b	0	0	0	0	0	0
Neni 233	0	0	0	0	0	0
Neni 234	0	0	0	0	0	0
Neni 234/a	0	0	0	0	0	0
Neni 234/b	0	0	0	0	0	0
Grupi 9: Vepra penale të Krimin të Organizuar	0	0	0	0	3	80
Neni 333	0	0	0	0	0	3
Neni 333/a	0	0	0	0	2	36
Neni 334	0	0	0	0	1	41
Grupi 10: Krimi kibernetik	0	5	3	2	0	1
Neni 143/b	0	5	3	2	0	1
Grupi 11: Trafikimi i emigrantëve	3	52	1	65	0	1
Neni 298	3	52	1	65	0	1


Në grafikun e mëposhtëm, përfshihen dinamikat e numrit të personave, të dënuar dhe të pafajshëm nga **Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm**, për veprat penale në lidhje me Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në total) për vitet 2021, 2022, 2023, 2024 si dhe vitin 2025.



Në grafikun e mëposhtëm, përfshihen dinamikat e numrit të personave të dënuar dhe të pafajshëm nga **Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm**, për veprat penale në lidhje me Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në total) për vitet 2021, 2022, 2023, 2024 si dhe vitin 2025.



Në grafikun e mëposhtëm, përfshihen dinamikat e numrit të personave të gjykuar, të dënuar dhe të pafajshëm nga **Gjykata e Lartë**, për veprat penale në lidhje me Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (**në total**) për vitet 2021, 2022, 2023, 2024 si dhe vitin 2025.



Të gjitha çështjet për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2025, janë shqyrtuar në dhomë Këshillimi nga Gjykata e Lartë.

KREU VI

❖ ÇËSHJET E GJYKUARA PËR KRIMET NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SIPAS KODIT PENAL USHTARAK

ÇËSHJET E REGJISTRUARA PËR KRIMET NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SIPAS KODIT PENAL USHTARAK

Neni (Article)	Figura e Veprës Penale (Criminal act)	Çështje (Criminal cases)
33	Dezertimi (Desertion)	1
36/2	Mosparaqitja në repart ose në vendin e shërbimit (Non-appearance in the military unit or service post)	0
59	Vjedhja (The theft)	0
T O T A L I		1

ÇËSHJET E REGJISTRUARA PËR KUNDËRVAJTJE USHTARAKE (Cases tried for military contraventions)

Neni (Article)	Figura e Veprës Penale (Criminal act)	Çështje (Criminal cases)
35/1,2	Largimi pa leje (Leaving without permission)	0
36/1	Mosparaqitje në repart ose vendin e shërbimit (Non-appearance in the military unit or service post)	18
37/1	Mosparaqitja e oficerëve dhe nënoficerëve active (Failure of active officers and lieutenants)	1
46/1	Moszbatimi i urdhrit (Non-execution of the order)	0
49	Ulja e dinjitetit ushtarak (Lowering military dignity)	0
T O T A L I		19

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE USHTARAKE ME VENDIME GJYQËSORE PËRFUNDIMTARE

<input type="checkbox"/> Me vendim fajësie	15
<input type="checkbox"/> Me vendim pafajësie	0
<input type="checkbox"/> Vendosur pushimi i çështjes	3
<input type="checkbox"/> Vendosur kthimi për plotësim hetimesh	0
<input type="checkbox"/> Vendosur moskompetenca	0

	18

PARAQITJA ANALITIKE E TË DHËNAVE STATISTIKORE TË ÇËSHTJEVE PENALE USHTARAKE

Dinamika dhe mënyra e përfundimit për vitin 2025 paraqitet si vijon:

- Çështje të mbartura **5** (0 Krime, 5 Kundërvajtje);
- Ardhur gjatë vitit **15** (1 Krim, 14 Kundërvajtje);
- Ardhur pas prishjes **0** çështje (0 Krime, 0 Kundërvajtje);
- Gjithsej për gjykim **20** (1 Krim, 19 Kundërvajtje);
- Kanë përfunduar së gjykuari **18** çështje (1 Krim, 17 Kundërvajtje) ku është dhënë :
- Fajësi për **15** çështje;
- Pafajësi për **0** çështje;
- Pushim vendimi për **3** çështje;
- Kthim për plotësim hetimesh **0** çështje;
- Moskompetencë **0** çështje;
- Kanë mbetur pa përfunduar **2** çështje (0 Krime, 2 Kundërvajtje).

SHPEJTËSIA E GJYKIMIT

Në periudhën **0- 6 muaj**, është përfunduar gjykimi i **15** çështjeve (0 krime + 15 kundërvajtje penale ushtarake).

Në periudhën nga **6 muaj–1 vit**, është përfunduar gjykimi i 2 çështjeve (1 krim + 1 kundërvajtje penale ushtarake).

Në periudhën nga **1 deri në 2 vjet**, është përfunduar gjykimi i 1 çështjeje (0 krime dhe 1 kundërvajtje penale ushtarake).

Për periudhën **mbi 2 vjet**, është përfunduar gjykimi i **0** çështje penale ushtarake (0 krime dhe 0 kundërvajtje penale ushtarake).

Të dhënat e grupuara në mënyrën tabelare paraqiten si vijon:


Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm (First Instance Courts of General Jurisdiction)	0 -6 muaj (0 - 6 months)	6 muaj - 1 vit (6 months-1 year)	1 - 2 vjet (1 - 2 years)	Mbi 2 vjet (Over 1 years)
K R I M E				
Berat	-	-	-	-
Dibër	-	-	-	-
Durrës	-	-	-	-
Elbasan	-	-	-	-
Gjirokastrë	-	-	-	-
Korçë	-	-	-	-
Shkodër	-	-	-	-
Tiranë	-	-	-	-
Vlorë	-	1	-	-
TOTALI	0	1	0	0

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm (First Instance Courts of General Jurisdiction)	0 - 6 muaj (0 - 6 months)	6 muaj - 1 vit (6 months-1 year)	1 - 2 vjet (1 - 2 years)	Mbi 2 vjet (Over 1 years)
	KUNDËRVAJTJE			
Berat	10	1	1	-
Dibër	-	-	-	-
Durrës	1	-	-	-
Elbasan	-	-	-	-
Gjirokastrë	-	-	-	-
Korçë	-	-	-	-
Shkodër	3	-	-	-
Tiranë	1	-	-	-
Vlorë	-	-	-	-
TOTALI	15	2	1	0

Për 18 çështjet ushtarake të përfunduara 83% e tyre kanë një afat shqyrtimi deri 6 muaj, 11% në periudhën 6 muaj - 1 vit, 6% kanë përfunduar me afat shqyrtimi 1 – 2 vjet dhe 0% kanë përfunduar me afat shqyrtimi mbi 2 vjet.

ÇËSHJET USHTARAKE

Çështjet penale ushtarake (Military criminal cases)	Përfunduar	Papërfunduar	TOTALI
	(Terminated cases)	(Pending)	
Viti (year) 2021	36	9	45
Viti (year) 2022	28	13	41
Viti (year) 2023	48	13	61
Viti (year) 2024	21	4	25
Viti (year) 2025	18	2	20



ANKIMIMET

Në vitin 2025 për të gjitha çështjet e përfunduara, janë apeluar **0** çështje (0 për krime dhe 0 për kundërvajtjet).

DËNIMET

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Berat** janë regjistruar **12** çështje penale ushtarake gjithsej për vitin 2025 nga të cilat: **12** çështje kanë përfunduar dhe 0 çështje nuk kanë përfunduar. Për **10** çështje është dhënë vendim fajësie ndërsa për **2** çështje është vendosur pushimi.

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Berat**, janë gjykuar **12** persona dhe janë dhënë **5** dënime me gjobë, **6** dënime me burgim deri në 2 vjet dhe për 1 person është vendosur pushimi.

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Durrës** është regjistruar **1** çështje penale ushtarake gjithsej për vitin 2025 e cila është përfunduar me vendim fajësie.

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Durrës**, është gjykuar 1 person dhe është dhënë **1** dënim deri në 2 vjet burg.

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Tiranë** është regjistruar **1** çështje penale ushtarake gjithsej për vitin 2025 e cila është përfunduar me vendim pushimi.

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Tiranë**, është gjykuar 1 person dhe është dhënë vendim pushimi.

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Shkodër** janë regjistruar **5** çështje penale ushtarake gjithsej për vitin 2025 nga të cilat: **3** çështje janë përfunduar dhe **2** çështje nuk kanë përfunduar. Për **3** çështje është dhënë vendim fajësie.

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Shkodër**, janë gjykuar **3** persona dhe janë dhënë **3** dënime me gjobë.

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Vlorë** është regjistruar **1** çështje penale ushtarake gjithsej për vitin 2025 nga e cila: **1** çështje është përfunduar. Për **1** çështje është dhënë vendim fajësie.


Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Vlorë**, janë gjykuar **2** persona dhe janë dhënë **2** dënime deri në 2 vjet burg.

Në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (**Korçë, Dibër, Elbasan dhe Gjirokastrë**) nuk është regjistruar asnjë çështje penale ushtarake gjithsej për vitin 2025.

Në shkallë vendi janë gjykuar **19** persona, ku janë dënuar **17** persona dhe për **2** persona është vendosur pushimi.

Nga **17** persona ndaj të cilëve është dhënë vendim fajësie, kemi panoramën si vijon:

- Me gjobë, **8** persona;
- Burgim deri 2 vjet, **9** persona;
- Lirim nga ushtria, **0** persona;
- Dënim plotësues, **0** persona;
- Burgim 2 deri 5vjet, **0** persona;
- Burgim 5 deri 10 vjet, **0** persona;
- Burgim 10 deri 25 vjet, **0** persona;
- Burgim të përjetshëm, **0** persona.



Krahasime të çështjeve ushtarake të gjykuara me katër vite më parë

Krahasuar me vitet 2021, 2022, 2023 dhe me vitin 2024, çështjet penale ushtarake të regjistruara dhe të gjykuara në vitin 2025 në volum reflektojnë një ulje të tyre, me një luhatje gjatë viteve 2021 dhe 2023. Në vitin 2025 ulja e çështjeve penale ushtarake është vijon pas uljes së theksuar në vitin 2024. Konkretisht: në masën 25 çështje të regjistruara më pak krahasuar me vitin 2021 dhe 18 çështje më pak në shqyrtimin e çështjeve. Në masën 21 çështje më pak të regjistruara dhe 10 çështje të shqyrtuara më pak krahasuar me vitin 2022, në masën 41 çështje më pak të regjistruara dhe 30 çështje të shqyrtuara më pak krahasuar me vitin 2023. Në krahasim me vitin 2024, janë 5 çështje të regjistruara më pak dhe 3 çështje më pak të shqyrtuara në vitin aktual 2025.

Lidhur me **modën** e veprave penale ushtarake të gjykuara gjatë këtyre viteve të fundit kemi: **klasë modale kundërvajtjet për vitet 2021, 2022, 2023, 2024 dhe vitin 2025.**

8 krime dhe 28 kundërvajtje = **36** çështje të shqyrtuara në vitin **2021** (ku kemi klasë modale kundërvajtjet).

5 krime dhe 23 kundërvajtje = **28** çështje të shqyrtuara në vitin **2022** (ku kemi klasë modale kundërvajtjet).

5 krime dhe 43 kundërvajtje = **48** çështje të shqyrtuara në vitin **2023** (ku kemi klasë modale krimet).

2 krime dhe 19 kundërvajtje = **21** çështje të shqyrtuara në vitin **2024** (ku kemi klasë modale krimet).

Për vitin 2025, kemi **1** krim dhe **17** kundërvajtje = **18** çështje të shqyrtuara. Pra edhe për këtë vit kemi klasë modale **kundërvajtjet**.

Në vitin 2021 kundërvajtjet zënë një përqindje më të lartë se krimet (**22%**) në tërësinë e çështjeve penale ushtarake (të regjistruara). Konkretisht **78%** të tyre.

Në vitin 2022 kundërvajtjet zënë një përqindje më të lartë se krimet (**18%**) në tërësinë e çështjeve penale ushtarake (të regjistruara). Konkretisht **82%** të tyre.

Në vitin 2023 kundërvajtjet zënë një përqindje më të lartë se krimet (**10%**) në tërësinë e çështjeve penale ushtarake (të regjistruara) konkretisht **90 %** të tyre.

Në vitin 2024 kundërvajtjet zënë një përqindje më të lartë se krimet (**8%**) në tërësinë e çështjeve penale ushtarake (të regjistruara) konkretisht **92 %** të tyre.

Në vitin 2025, **kundërvajtjet** zënë një përqindje më të lartë se krimet (**6%**) në tërësinë e çështjeve penale ushtarake (të regjistruara). Konkretisht **94%** të tyre.

Si rezultat i luhatjes së çështjeve penale ushtarake të gjykuara dhe strukturës së tyre gjatë 5 viteve të fundit edhe numri i personave të gjykuar për konsumimin e këtyre veprave është me luhatje në vite të ndryshme. Kështu p.sh. në vitin 2021, kemi **38** persona të gjykuar dhe **38** persona të dënuar. Në vitin 2022, kemi **28** persona të gjykuar dhe **28** persona të dënuar. Në vitin 2023, kemi **59** persona të gjykuar dhe **50** persona të dënuar. Në vitin 2024, kemi **21** persona të gjykuar dhe **18** persona të dënuar. Në vitin 2025, kemi **19** persona të gjykuar dhe **17** persona të dënuar.

Në këtë vit, kemi një numër të lartë të personave të dënuar në raport me personat e gjykuar. Gjithashtu, në këtë vit kemi **2** persona për të cilët është vendosur pushimi. Në të gjitha vitet paraardhëse ka një luhatje jo shumë të madhe të numrit të të dënuarve me numrin e pesonave të gjykuar për vepra penale ushtarake.

Për të dënuarit për këto vepra penale **moda për vitin 2025 janë të dënuarit me burgim deri në 2 vjet.**

KREU VII

❖ KRIMINALITETI PËR TË MITURIT

KRIMINALITETI (TË MITURIT)

Të dhënat statistikore për kriminalitetin e të miturit, krahasuar me vitet 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025 pasqyrojnë një luhajtje të theksuar të fenomenit me ulje dhe ngritje të numrit të fëmijëve të dënuar për vepra penale.

Të dënuar të mitur gjatë vitit 2025 janë **245**, nga të cilët **231** të dënuar për krime dhe **14** të dënuar për kundërvajtje penale.


Nga kjo kategori të dënuarish, në vitin 2019 janë regjistruar **280** të dënuar të mitur (265 për krime dhe 15 për kundërvajtje), në vitin 2020 janë regjistruar **158** të dënuar të mitur (155 për krime dhe 3 për kundërvajtje), si dhe vitin 2021 janë regjistruar **212** të dënuar të mitur (197 për krime dhe 15 për kundërvajtje), në vitin 2022 janë regjistruar **219** të dënuar të mitur (205 për krime dhe 14 për kundërvajtje penale), në vitin 2023 janë regjistruar **186** të dënuar të mitur (169 për krime dhe 17 për kundërvajtje penale) si dhe në vitin 2024 janë regjistruar **177** të dënuar të mitur (171 për krime dhe 6 për kundërvajtje penale). Në vitin 2025 janë regjistruar **245** të dënuar të mitur (231 për krime dhe 14 për kundërvajtje penale).

Veçori është se edhe për këtë vit, 94% e të dënuarve të mitur janë për krime. E parë nga ana tabelare mund të thuhet se në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024, numri i të dënuarve të mitur ka pësuar rritje me **68** të dënuar. Duke u krahasuar me të dënuarit në shkallë vendi (**8,956 sipas KP**), të dënuarit e mitur janë **2.7 %** e tyre.

Në mënyrë grafike dhe tabelare, krahasimet lidhur me të dënuarit e mitur në shtatë vitet e fundit jepen si vijon:

Të dënuar të mitur (Juvenile delinquency)	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Për krime (Criminal offenses)	265	155	197	205	169	171	231
Për kundërvajtje (Contraventions)	15	3	15	14	17	6	14
Totali	280	158	212	219	186	177	245

TË DËNUARIT TË MITUR, VEPRA PENALE PËR TË CILËN DËNOHEN DHE MASA E DËNIMIT



Neni	Të dënuar	Të pafajshëm	Pushuar	Pa arsim	Me arsim	Gjobë	Deri në 2 vjet	2-5 vite	Kufizimi i lirisë	Neni 59	Neni 59 / a	Neni 63	Neni 64	Neni 46	5-10 vite	10-25 vite
76	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
79	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0
79/a	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0
82	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
88	9	0	0	3	6	5	1	1	0	0	2	0	0	0	0	0
100	7	0	0	1	6	4	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0
101	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
109/b	3	0	0	1	2	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
110/2	3	0	0	3	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0	0
117/2,3	3	0	0	1	2	0	1	0	0	0	0	1	1	0	0	0
121/a	2	0	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
130/a,2,3,4	5	0	0	3	2	3	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0
134	80	0	1	24	56	51	9	3	0	3	6	6	2	0	0	0
139	9	0	0	5	4	6	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
143/b	2	0	0	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
154	2	0	0	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
172	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0
183	2	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0
190	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
236/2	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
278/1,2,4,5,6,7,8	4	0	0	2	2	1	0	0	0	0	1	1	1	0	0	0
279	12	0	1	2	10	6	1	0	0	0	3	1	1	0	0	0

283	17	0	1	4	13	9	0	2	1	1	3	0	1	0	0	0
283/a	2	0	0	0	2	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
284	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
287	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
290/2,3,4	6	0	0	0	6	0	2	0	0	1	1	2	0	0	0	0
291	48	0	1	6	42	20	4	0	0	7	3	12	2	0	0	0
300	2	0	0	0	2	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
301	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
323	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Te Tjera	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shuma	231	0	4	59	172	118	26	6	1	15	26	24	13	0	2	0

Neni	Të dënuar	Të pafajshëm	Pushuar	Pa arsim	Me arsim	Gjobë	Deri në 2 vjet	2-5 vite	Kufizimi i lirisë	Neni 59	Neni 59 / a	Neni 63	Neni 64	Neni 46	5-10 vite	10-25 vite
84	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
89	3	0	3	1	2	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0
117/1	2	0	0	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
130/a1	3	0	0	1	2	0	0	0	0	0	2	1	0	0	0	0
197	1	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
207	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
242	1	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
280	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
321	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shuma Kv	14	0	4	3	11	5	2	0	0	1	3	3	0	0	0	0

KRIME TË KRYERA NGA FEMRAT DHE NUMRI I TË DËNUARAVE

(Article)	(Female convicts)	(Article)	(Female convicts)
78	1	187	5
81	3	188	3
88	2	189	10
96	3	190	10
100	1	197	1
109/a	1	199/a/3,4	13
109/b	4	235/2	2
110/a	1	236/2	1
113	22	237	5
114	6	244/2	2
121/a	4	245/1/2,4	2
124	5	248	27
124/b,2,3	8	248/a	3
130/a,2,3,4	32	259	1
134	29	278/1,2,4,5,6,7,8	3
135	13	279	1
137	14	283	24
139	1	284	1
143	36	285	3
143/b	1	287	1
144/a	3	288/c	1
145	3	289	2
146	6	290/2,3,4	17
150	4	291	48
151	1	298	3
161	1	300	4
170/c	1	301	3
170/ç	9	305	2

174	13	323	9
178	2	324	1
180	5	324/a	4
181	1	327	2
183	1	Te Tjera	1
186	8		
SHUMA KRIME 460			


(Article)	(Female convicts)	(Article)	(Female convicts)
89	2	199/a,1,2	5
90	6	235/1	1
112	1	236/1	3
119	26	238/1	1
120	19	242	1
122	1	257/a/1	2
124/b1	1	258/1	4
125	4	272	1
126	1	273	4
127	9	274	2
130	1	275	2
130/a1	17	277	3
159/1	1	280	2
179/a	3	318	1
192	1	320	2
197	1	321	2
199	1	Te Tjera	6
SHUMA KV 137			

LLOJI I VEPRAVE PËR TË DËNUARAT FEMRA

Të dënuara femra (Female convicts)	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Per krime (For criminal offenses)	474	338	489	446	327	353	460
Për kundërvajtje (For Contraventions)	261	188	209	124	134	113	137
Totali	735	526	698	570	461	466	597

Numri i të dënuarave femra, krahasuar me të dënuarit në përgjithësi, është në shifra të ulëta, me **597** të dënuara ose **7%** e numrit të përgjithshëm të të dënuarve. Krahasuar me të dënuarat femra të vitit 2024, kemi një rritje me **131** të dënuara femra më shumë, kemi një rritje të dënuarash nga kjo kategori shoqërore me **136** të dënuara më shumë në krahasim me vitin 2023, me **37** të dënuara më shumë se në vitin 2022, me **101** të dënuara më pak se në vitin 2021, një rritje me **71** të dënuara më shumë se në vitin 2020 dhe me **138** të dënuara më pak se në vitin 2019. Nga 597 femra të dënuara gjatë vitit 2025, për **krime** janë dënuar **460** dhe për **kundërvajtje penale** **137**, pra **77%** e të dënuarave janë për krime dhe **23%** për kundërvajtje penale.

TË DËNUARA FEMRA



KREU VIII

- ❖ **PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT ME BURGIM, SHËRBIMI I PROVËS, ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME BURGIM DHE MBIKËQYRJA ELEKTRONIKE**

SHËRBIMI I PROVËS, ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME BURGIM DHE MBIKËQYRJA ELEKTRONIKE

Privimi i lirisë në vendet e përparuara të Europës, për një sërë veprash me rrezikshmëri të vogël shoqërore vlerësohet si sanksion i alternativës së fundit dhe si rrjedhojë zbatohet atëherë kur rrezikshmëria e veprës penale të kryer do të bënte të pamundur vendosjen e ndonjë mase tjetër alternative. Në mënyrë të veçantë, vendet e Evropës Perëndimore përpiqen të kufizojnë sa të jetë e mundur burgimin duke tentuar drejt formave zëvendësuese të një trajtimi jo-shtrëngues. Kjo bazohet në premisën se burgimi përveçse jep efekte negative tek shkelësit e ligjit, ka dhe një kosto financiare shumë të lartë për shoqërinë.

Si pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë, me Ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, si dhe Ligjit nr. 80/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kuadrin normativo-ligjor për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës si organ shtetëror i specializuar për mbikëqyrjen e dënimeve alternative ndaj burgimit.

Është miratuar ligji i ri nr.79/2020 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale, i cil ka shfuqizuar ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Shërbimi i provës është organi shtetëror që paraqet informacion para autoriteteve gjyqësore, mbikëqyr ekzekutimin e dënimit alternativ dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social.

Që me krijimin e Shërbimit të Provës vazhdon me intesitet procesi i aplikimit të dënimeve alternative dhe treguesit numerikë janë pozitivë.

Misioni parësor është mbrojtja e komunitetit dhe parandalimi i recidivizmit (përsëritjes së veprës penale), asistimi dhe konsultimi për riintegrimin dhe risocializimin me sukses në komunitet të shkelësve të ligjit duke ndihmuar, nëpërmjet metodave dhe instrumenteve më bashkëkohore, në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin shoqëror dhe sjelljen e ndryshimeve pozitive në jetën e tyre.

Qëllimi i Shërbimit të Provës në Shqipëri është mbikëqyrja dhe mbështetja e:

- Zbatimit të dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike;
- Parandalimit të kryerjes së veprave penale,
- Asistimit të personit të dënuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternative;
- Bashkëpunimit dhe paraqitjes së informacionit dhe raporteve para prokurorisë dhe gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm.

Tashmë, Shërbimi i Provës është funksional dhe po bën përpjekje maksimale për rritjen e tij profesionale. Tani më janë të qarta për gjithë stafin se çfarë është Shërbimi i Provës, cili është roli dhe detyra e këtij organi në sistemin e drejtësisë penale, cili është roli dhe misioni i Shërbimit të Provës në Shqipëri, çfarë duhet të bëjë punonjësi i Shërbimit të Provës, cilat janë format e punës, cili është raporti i tij me faktorët e tjerë të drejtësisë penale (gjykatën, prokurorinë, burgjet, policinë e shtetit etj.) apo, cilat janë format e bashkëpunimit të këtij shërbimi me organet e pushtetit qendror, si Policia e Shtetit, etj., me organet e pushtetit vendor, (qarqe, bashki dhe komuna), si dhe me OJF-të etj.

Shërbimi i Provës, punon në komunitet me ata që kanë kryer vepra penale me rrezikshmëri të çdo niveli, kryen të gjitha procedurat ligjore për mbikqyrjen e të dënuarit në komunitet, në periudhën e provës; i dërgon

raport prokurorit për rastet e shkeljeve të kushteve të kohës së provës. Aktualisht Shërbimi i Provës i ka dërguar prokurorit në mjaft raste propozimet përkatëse për shkeljet e kushteve të kohës së provës nga i dënuari dhe për të cilët kane filluar procedurat e kthimit të tij në burg për vuajtjen e kohës së mbetur të dënimit.

Vepërtaria e Shërbimit të Provës

Privimi i lirisë në vendet e përparuara të Evropës, për një sërë veprash me rrezikshmëri të vogël shoqërore vlerësohet si sanksion i alternativës së fundit dhe si rrjedhojë zbatohet atëherë kur rrezikshmëria e veprës penale të kryer do të bënte të pamundur vendosjen e ndonjë mase tjetër alternative. Në mënyrë të veçantë, vendet e Evropës Perëndimore përpiqen të kufizojnë sa të jetë e mundur burgimin duke tentuar drejt formave zëvendësuese të një trajtimi jo-shtrëngues. Kjo bazohet në premisën se burgimi përveçse jep efekte negative tek shkelësit e ligjit ka dhe një kosto financiare shumë të lartë për shoqërinë.

Duke marrë shkas nga përvoja e suksesshme e këtyre vendeve, alternativat e dënimit me burgim janë prezantuar në Kodin Penal të Shqipërisë në vitin 1995, por me rishikimin e vitit 2008 u ndryshuan dhe u përmirësuan përcaktimet në lidhje me to, përmirësime të cilat lejojnë hapësirë më të gjerë për zbatimin në praktikë të tyre, rezultat i të cilës është dhe fillimi i funksionimit të institucionit të Shërbimit të Provës i cili mbikëqyr ekzekutimin e këtyre dënimeve.

Si pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë, me Ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008, si dhe Ligjit nr. 80/2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kuadrin normativo-ligjor për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës si organ shtetëror i specializuar për mbikëqyrjen e dënimeve alternative ndaj burgimit.

Vlerat në themel të aktivitetit të Shërbimit të Provës janë, respekti për dinjëtin njerëzor, koncepti i mundësive të individit për të ndryshuar dhe për t'u rritur, si dhe të qëniet i drejtë dhe i paanshëm. Herë pas here, kërkohet rritja e performancës së punonjësve të Shërbimit të Provës, marrja e masave për mbikëqyrjen elektronike, ndjekjen me profesionalizëm dhe pa mungesa të proceseve gjyqësore, zbatimin e masave të reja për të miturit në përputhje me Kodin e Drejtësisë për të Miturit dhe aktet nënligjore për zbatim.

Misioni parësor është mbrojtja e komunitetit dhe parandalimi i recidivizmit (përsëritjes së veprës penale), asistimi dhe konsultimi për riintegrimin dhe risocializimin me sukses në komunitet të shkelësve të ligjit duke ndihmuar, nëpërmjet metodave dhe instrumenteve më bashkëkohore, në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin shoqëror dhe sjelljen e ndryshimeve pozitive në jetën e tyre. Roli i Shërbimit të Provës brenda sistemit të drejtësisë penale është ai i asistimit të gjykatës dhe prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm në lidhje me vlerësimin dhe individualizimin e alternativës së dënimit për secilin prej shkelësve të ligjit, si dhe në përdorimin e metodave sociale të ndërhyrjes për t'u siguruar për mbarëvajtjen e ekzekutimit të alternativës të dënimit me burgim dhe për t'u siguruar që personi i rikthyer në komunitet të mos përbëjë rrezik për të tjerët apo për veten e tij.

Thelbi i rolit të shërbimit të provës si një vlerë e shtuar në sistemin e drejtësisë penale mbetet ai vlerësues, parandalues dhe trajtues, me synim uljen e aktivitetit kriminal në shoqëri dhe më shumë siguri për jetesën në komunitet.

E përbashkëta e dënimeve alternative qëndron në zëvendësimin e dënimit me burgim me mbikëqyrje në komunitet. Kjo të lejon të kryesh një jetesë normale pranë familjes, shkollës, vendit të punës, pranë një qendre rehabilitimi, etj. pra, dënimi kryhet në ambiente jo të izoluar, siç ndodh në rastin e dënimit me burgim. Dënimi me burgim është parë në të shkuarën si masa më e mirë për të rritur sigurinë e komunitetit dhe dënimin e veprimeve kriminale duke synuar uljen apo eliminimin e tyre. Megjithatë, jo gjithmonë ky është rasti. Rezultatet e rehabilitimit dhe riintegritimit nëpërmjet izolimit me burgim janë të përziera, që do të thotë

se jo gjithmonë ka dhënë efektin e dëshiruar, duke hapur kështu horizonte të reja e duke e zhvendosur theksin e dënimit nga ndëshkimi te trajtimi i shkelësit të ligjit.

Për secilin prej dënimeve alternative ekzistojnë kritere të posaçme të parashikuara në Kodin Penal. Kryesisht, përfitues të tyre janë persona me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si dhe persona të cilët shfaqin vullnet për riintegrim të shpejtë në shoqëri.

Llojet e dënimeve alternative:

Nëse je nën hetim apo i pandehur, mund të përfitosh, gjatë fazës së dhënies së vendimit gjyqësor, alternativën e dënimit me burgim, e cila përputhet me veprën penale, dëmin e shkaktuar dhe rrezikshmërinë shoqërore.

- Pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në periudhë prove

Po gjatë fazës së dhënies së dënimit, mund të përfitosh nga pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në periudhë prove, në rast se dënimi juaj me burgim nuk është më i lartë se 5 vjet. Faktorë lehtësues për të përfituar këtë alternativë të dënimit me burgim janë: rrezikshmëria e ulët, mosha, kushtet shëndetësore dhe mendore, mënyra e jetesës dhe nevojat, sjellja pas kryerjes së veprës penale etj. Kjo alternativë parashikon vënien në periudhë prove dhe mbikëqyrjen nga ana e Shërbimit të Provës të ecurisë së përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimin gjyqësor. Periudha e provës mund të zgjasë nga 18 muaj deri në 5 vjet.

- Gjysmëliria

Gjysmëliria është një alternativë tjetër të cilën mund ta përfitosh gjatë fazës së dhënies së dënimit apo gjatë kohës kur ke filluar të vuash dënimin me burgim. Në çdo rast, dënimi me burgim nuk duhet të jetë më i lartë se 1 vit. Gjysmëliria jepet për shkak të detyrimeve që mund të keni për të punuar, për t'u arsimuar, kualifikuar ose aftësuar profesionalisht, apo për shkak të përgjegjësive familjare dhe për nevojën për trajtim shëndetësor. Personi që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut.

- Qëndrimi në shtëpi

Qëndrimi në shtëpi është alternativa, e cila jepet për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit. Ajo parashikon vuajtjen e dënimit në shtëpinë tuaj, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, por kjo vetëm nëse gjendesh në disa rrethana të përcaktuara, si p.sh., nëse je grua shtatzënë ose nënë me fëmijë nën moshën 10 vjeç, nëse je baba me përgjegjësi prindërore për fëmijën, nëse je në kushte të rënda shëndetësore, apo je nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare. Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm mund të të lejojë të largohesh nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat Shërbimi i Provës është dakord.

- Lirimi me kusht

Një tjetër alternativë, e cila zbatohet për personat të cilët nuk janë të dënuar më parë për krime të kryera me dashje është Lirimi me kusht. Në këtë rast mund të lirohesh vetëm për arsye të veçanta dhe nëse me sjelljen dhe punën tënde tregon se me dënimin e vuajtur gjatë kohës së burgimit është arritur qëllimi për edukimin tënd, si dhe të kesh vuajtur:

- a) jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- b) jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;
- c) jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.

- Kryerja e punës me interes public

Një nga këto alternativa, e cila jepet gjatë fazës së dhënies së dënimit është kryerja e punës në interes publik. Ajo nënkupton kryerjen e një sasive orësh (nga 40 deri në 240 orë) punë të papaguar në interes të komunitetit, në vend të kryerjes së dënimit me burgim. Zbatimi i këtij dënimi mbikëqyret nga Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me qendrat pritëse dhe zgjat deri në përfundimin e sasisë së përcaktuar të orëve dhe kryerjes me sukses të punës së caktuar. Që të mund të shlyeni dënimin e shkaktuar nëpërmjet punës në interes publik dhe jo me burgim, duhet të mos kesh marrë një dënim me burgim më të lartë se 1 vit. Pavarësisht nga sasia e orëve, puna në interes publik duhet të kryhet brenda një afati prej 6 muajsh.

Mbikëqyrja

Që nga Marsi i viti 2013, Shërbimi i Provës është institucioni realizues edhe i Mbikëqyrjes Elektronike.

Kufizimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor, mbikëqyren nëpërmjet pajisjes e cila vendoset në trupin e personit nga salla operative e ngritur për këtë qëllim. Pajisja i komunikon sallës operative daljen nga zona e lejuar apo hyrjen në zonën e ndaluar duke treguar vendndodhjen e personit të mbikëqyruar.

Për mbarëvajtjen e ecurisë së dënimit alternativ, i cili është caktuar me vendim gjyqësor, do të jenë nën mbikëqyrje nga Shërbimi i Provës. Kjo nënkupton mbajtjen e një kontakti të shpeshtë me specialistin e mbikëqyrës, i cili në sajë të bashkëpunimit do të mund të të asistojë në sfidat apo problematikat e ndryshme që mund të hasen në rrugën drejt riintegritimit në shoqëri.

Tabela e mëposhtëme jep shtrirjen e kompetencave tokësore të rretheve sipas ZVSHP-ve. Këtu me rrethet kemi parasysh ndarjen administrative të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Nr	Zyra Vendore	Rrethet administrative
1	Tiranë	Tiranë
2	Shkodër	Shkodër Koplik
3	Kukës	Kukës Has
4	Lezhë	Lezhë Rreshen
5	Mat	Burrel
6	Durrës	Durrës
7	Fier	Fier Ballsh
8	Elbasan	Elbasan Gramsh Peqin Librazhd
9	Berat	Berat Skrapar Kuçovë
10	Korçë	Korçë Bilisht Ersekë
11	Vlorë	Vlorë
12	Gjirokastrë	Gjirokastrë Tepelenë
13	Kavajë	Kavajë
14	Krujë	Krujë
15	Pukë	Pukë
16	Kurbin	Laç
17	Pogradec	Pogradec
18	Përmet	Përmet
19	Sarandë	Sarandë Delvinë
20	Dibër	Dibër Bulqizë
21	Tropojë	Bajram Curri

22	Lushnje	Lushnje
----	---------	---------



Numri total i të dënuarve me dënime alternative që mbikqyren nga Shërbimi i Provës


Për vitin 2025, numri i të dënuarve me dënime alternative shkoi në 5,537 të dënuar me dënime alternative. Mbikqyrja për secilin prej tyre realizohet mbi bazën e programeve individuale të trajtimit.

Nëse nuk do të ishin aplikuar alternativat e dënimit me burgim, sikurse parashikohej në Kodin Penal para ndryshimeve të bëra me anë të ligjit Nr.10023, datë 27.11.2008, si dhe Ligjit nr. 80/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, atëherë këta 5,537 persona do të ishin duke vuajtur dënimin me burg, në një nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP).

- Për vitin 2021 janë **6,747** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.
- Për vitin 2022 janë **6,688** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.
- Për vitin 2023 janë **6,679** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.
- Për vitin 2024 janë **5,210** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.
- Për vitin 2025 janë **5,537** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.

Në mënyrë tabelare dhe grafike sipas llojit të dënimit për vitet 2021, 2022, 2023, 2024 dhe viti 2025 kemi pasqyrën si më poshtë:

LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Neni 59 i KP, Pezullimi	5,579	5,356	5,457	4,363	4,588
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	49	59	34	22	19
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	148	146	89	39	37
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	970	1,125	1,097	786	893
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	1	2	2	0	0
TOTALI	6,747	6,688	6,679	5,210	5,537



PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT ME BURGIM

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm në rastet kur jep dënim deri në 5 vjet burg në varësi të rrezikshmërisë së pakët shoqërore të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, mund të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe i dënuari të vihet në provë për një afat nga 18 muaj deri në 5 vjet.

Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, siç është parashikuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikqyrjes brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.

Krahasuar me të dënuarit deri 5 vjet për të cilët është e mundur të zbatohet Neni 59 i KP “Pezullimi”, rezulton se është pezulluar ekzekutimi i dënimit për **4,195 të dënuar**.

Krahasuar me pesë vitet e fundit pasqyrojmë numrin e të dënuarve që kanë përfitur nga neni 59 i Kodit Penal.

Krahasuar me vitin 2024 ku rezultojnë 8,907 të dënuar dhe për 3,065 persona është pezulluar dënimi me burgim, për 2025 janë **1,130** raste më pak që përfitojnë nga neni 59.

Krahasuar me vitin 2023 ku rezultojnë 8,993 të dënuar dhe për 3,763 persona është pezulluar dënimi me burgim, për 2025 janë **432** raste më shumë që përfitojnë nga neni 59.

Krahasuar me vitin 2022 ku rezultojnë 11,203 të dënuar dhe për 3,221 persona është pezulluar dënimi me burgim, për 2025 janë **974** raste më shumë që përfitojnë nga neni 59.

Krahasuar me vitin 2021 ku rezultojnë 12,603 të dënuar dhe për 5,579 persona është pezulluar dënimi me burgim, për 2025 janë **1,384** raste më pak që përfitojnë nga neni 59.

Për vitin 2021 numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë, arrin në 55,400. Nga këto padi civile, ato të cilat janë me palë kundërshtare arrijnë 22,446 ndërsa paditë civile pa palë kundërshtare të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë rreth 32,954. Në vitin 2021 nga Gjykatat e Shkallës së Parë në rang Republike, janë gjykuar 5,200 padi civile me palë më shumë, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2020, si edhe 13,312 padi civile pa palë më shumë, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2020. Në vitin 2021 nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë gjykuar 1,774 padi civile me palë më pak, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2019. Krahasuar me vitin 2018 kanë përfunduar së shqyrtuari 2,928 padi civile me palë kundërshtare më pak për vitin 2021. Krahasuar po me vitin 2018, kanë përfunduar së shqyrtuari 4,500 padi civile pa palë kundërshtare më shumë për vitin 2021. Në vitin 2021 nga Gjykatat e Shkallës së Parë në rang Republike, janë gjykuar 5,160 padi civile me palë më pak krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2017, si edhe 337 padi civile pa palë më pak krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2017.

Për vitin 2022 numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë, arrin në 50,913. Nga këto padi civile, ato të cilat janë me palë kundërshtare arrijnë 20,596, ndërsa paditë civile pa palë kundërshtare të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë rreth 30,317. Në vitin 2022 nga Gjykatat e Shkallës së Parë në rang Republike, janë gjykuar 1,850 padi civile me palë më pak, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2021, si edhe 2,637 padi civile pa palë më pak, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2021. Në vitin 2022 nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë gjykuar 3,360 padi civile me palë më shumë, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2020, si edhe 10,675 padi civile pa palë më shumë, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2020. Në vitin 2022 nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë gjykuar 3,624 padi civile me palë më pak, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2019, si edhe 1,925 padi civile pa palë më shumë, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2019. Krahasuar me vitin 2018 kanë përfunduar së shqyrtuari 4,778 padi civile me palë kundërshtare më pak për vitin 2022. Krahasuar po me vitin 2018, kanë përfunduar së shqyrtuari 1,963 padi civile pa palë kundërshtare më shumë për vitin 2022.

Për vitin 2023 numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, arrin në 37,682. Nga këto padi civile, ato të cilat janë me palë

kundërshtare arrijnë 18,001 ndërsa paditë civile pa palë kundërshtare të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë rreth 19,681. Në vitin 2023 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 2,595 padi civile me palë më pak, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2022, si edhe 10,636 padi civile pa palë më pak, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2022. Në vitin 2023 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 4,445 padi civile me palë më pak, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2021, si edhe 13,273 padi civile pa palë më pak, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2021. Në vitin 2023 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 765 padi civile me palë më shumë, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në vitin 2020, si edhe 39 padi civile pa palë më shumë, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2020. Krahasuar me vitin 2019 kanë përfunduar së shqyrtuari 6,219 padi civile me palë kundërshtare më pak për vitin 2023. Krahasuar po me vitin 2019, kanë përfunduar së shqyrtuari 8,711 padi civile pa palë kundërshtare më pak për vitin 2023.

Për vitin 2024 numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë, arrin në 38,564. Nga këto padi civile, ato të cilat janë me palë kundërshtare arrijnë 20,361, ndërsa paditë civile pa palë kundërshtare të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë rreth 18,203. Në vitin 2023 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 2,360 padi civile me palë më shumë, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2023, si edhe 1,478 padi civile pa palë më pak, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2023. Në vitin 2024 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 235 padi civile me palë më pak, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2022, si edhe 12,114 padi civile pa palë më pak, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2022. Në vitin 2024 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 2,085 padi civile me palë më pak, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në vitin 2021, si edhe 14,751 padi civile pa palë më pak, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2021. Krahasuar me vitin 2020 kanë përfunduar së shqyrtuari 3,125 padi civile me palë kundërshtare më pak për vitin 2024. Krahasuar po me vitin 2020, kanë përfunduar së shqyrtuari 1,439 padi civile pa palë kundërshtare më pak për vitin 2024.

Për vitin 2025 numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë, arrin në 32,745. Nga këto padi civile, ato të cilat janë me palë kundërshtare arrijnë 18,884, ndërsa paditë civile pa palë kundërshtare të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë rreth 13,861. Në vitin 2025 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 1,477 padi civile me palë më pak, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2024, si edhe 4,342 padi civile pa palë më pak, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2024. Në vitin 2025 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 883 padi civile me palë më shumë, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë në vitin 2023, si edhe 5,820 padi civile pa palë më pak, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në

vitin 2023. Në vitin 2025 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjykuar 1,712 padi civile me palë më pak, krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në vitin 2022, si edhe 16,456 padi civile pa palë më pak, krahasuar me numrin e padive civile pa palë të shqyrtuara në vitin 2022. Krahasuar me vitin 2021 kanë përfunduar së shqyrtuari 3,562 padi civile me palë kundërshtare më pak për vitin 2025. Krahasuar po me vitin 2021, kanë përfunduar së shqyrtuari 19,093 padi civile pa palë kundërshtare më pak për vitin 2025.

Nga krahasimi i pesë viteve të fundit rezulton se në vitin 2025 numri i çështjeve të shqyrtuara dhe të përfunduara, është me një trend në rënie në krahasim me katër vitet e kaluara.

ANALIZË KRAHASUESE E PADIVE CIVILE TË VEÇANTA PËR PESË VITET E FUNDIT

Duke u nisur nga rëndësia e marrëdhënieve juridike civile, të cilat rregullohen nga dispozitat e të drejtës civile, ka disa padi për të cilat paditësi vë në lëvizje më shpesh gjykatën për të vendosur në vend interesin e tij të shkelur nga i padituri nëpërmjet organeve gjyqësore. Të tilla janë paditë që rrjedhin nga marrëdhëniet e pronësisë (**Nenet 149-231 KC**), paditë për kërkimin e sendit (**Nenet 296-303 KC**), paditë që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, paditë në të cilat kërkohet kundërshtimi i veprimit përmbartimor, paditë për shkaktim dëmi (**Nenet 608-654 KC**), si edhe çështjet civile me karakter administrativ. Më poshtë po japim situatën se si ka ndryshuar numri i këtyre padive të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm pesë vitet e fundit. Pra, në vitet 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025.

Paditë e pronësisë (Nenet 149-231 KC)

Për vetë rëndësinë që mbartin është e nevojshme të analizohet ecuria e numrit të padive të pronësisë (149-231 KC) të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në pesë vitet e fundit. Konstatohet që numri i konflikteve për çështjet e pronësisë përbën volumin më të madh të padive të paraqitura në gjykatë për shqyrtim nga palët paditëse.

Në vitin 2021 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë arrin në 1,279 çështje të përfunduara. Në vitin 2021 numri i padive të pronësisë është 237 çështje më shumë se në vitin 2020. Në vitin 2021 nga të gjitha Gjykatat e Shkallës së Parë janë shqyrtuar 315 padi pronësie më pak në krahasim me vitin 2019. Në krahasim me vitin 2018 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 486 padi më pak për vitin 2021. Në krahasim me vitin 2017 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 612 padi më pak për vitin 2021.

Në vitin 2022 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë arrin në 1,017 çështje të përfunduara. Në vitin 2022 numri i padive të pronësisë është 262 çështje më pak se në vitin

2021. Në vitin 2022 nga të gjitha Gjykatat e Shkallës së Parë janë shqyrtuar 25 padi pronësie më pak në krahasim me vitin 2020. Në krahasim me vitin 2019 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 577 padi më pak për vitin 2022. Në krahasim me vitin 2018 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 748 padi më pak për vitin 2022.


Në vitin 2023 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, arrin në 586 çështje të përfunduara. Në vitin 2023 numri i padive të pronësisë është 431 çështje më pak se në vitin 2022. Në vitin 2023 nga të gjitha Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë shqyrtuar 693 padi pronësie më pak në krahasim me vitin 2021. Në krahasim me vitin 2020 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 456 padi më pak për vitin 2023. Në krahasim me vitin 2019 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 1,008 padi më pak për vitin 2023.

Në vitin 2024 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, arrin në 611 çështje të përfunduara. Në vitin 2024 numri i padive të pronësisë është 25 çështje më shumë se në vitin 2023. Në vitin 2024 nga të gjitha Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë shqyrtuar 406 padi pronësie më pak në krahasim me vitin 2022. Në krahasim me vitin 2021 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 668 padi më pak për vitin 2024. Në krahasim me vitin 2020 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 431 padi më pak për vitin 2024.

Në vitin 2025 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, arrin në 469 çështje të përfunduara. Në vitin 2025 numri i padive të pronësisë është 142 çështje më pak se në vitin 2024. Në vitin 2025 nga të gjitha Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë shqyrtuar 117 padi pronësie më pak në krahasim me vitin 2023. Në krahasim me vitin 2022 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 548 padi më pak për vitin 2025. Në krahasim me vitin 2021 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 810 padi më pak për vitin 2025.

Në mënyrë tabelare dhe grafike, po paraqesim krahasimin e çështjeve të shqyrtuara me objekt padi pronësie për pesë vitet e fundit :

Periudha kohore	Gjithsej për gjykim	Përfunduar	Papërfunduar
	(Total)	(Examined)	(Pending)
Viti 2021	3,451	1,279	2,169
Viti 2022	3,461	1,017	2,444
Viti 2023	1,982	586	1,396
Viti 2024	1,906	611	1,295
Viti 2025	1,918	469	1,449



Padi të tjera kontraktuale

Pas padive të pronësisë dhe padive për marrëdhëniet e punës, një numër i konsiderueshëm padish të cilat janë paraqitur për t'u shqyrtuar nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë dhe paditë e tjera kontraktuale të cilat kanë pësuar një rritje nga viti në vit.

Në vitin 2021 numri i padive të tjera kontraktuale të regjistruara në Gjykatat e Shkallës së Parë është 1,570 dhe të shqyrtuara është 818 me një ulje prej 287 padi më pak se numri i padive të shqyrtuara në 2020. Duke krahasuar vitin 2021 me vitin 2019, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të të shqyrtuara për këtë vit është ulur me 613 padi më pak të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2018, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të shqyrtuara në vitin 2021 është ulur me 782 padi më pak. Ndërsa në krahasim me vitin 2017, vihet re përsëri një ulje e padive të tjera kontraktuale me 1,308 padi më pak të shqyrtuara në vitin 2021, si dhe më pak çështje të regjistruara në gjykata dy vitet e fundit.

Për vitin 2022 numri i padive të tjera kontraktuale të regjistruara në Gjykatat e Shkallës së Parë është 1,248 dhe të shqyrtuara është 631 me një ulje prej 187 padi më pak se numri i padive të shqyrtuara në 2021. Duke krahasuar vitin 2022 me vitin 2020, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të të shqyrtuara për këtë vit është ulur me 474 padi më pak të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2019, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të shqyrtuara në vitin 2022 është ulur me 800 padi më pak. Ndërsa në krahasim me vitin 2018, vihet re përsëri një ulje e padive të tjera kontraktuale me 969 padi më pak të shqyrtuara në vitin 2022, si dhe më pak çështje të regjistruara në gjykata dy vitet e fundit.

Për vitin 2023 numri i padive të tjera kontraktuale të regjistruara në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm është 931 dhe të shqyrtuara është 356 me një ulje prej 275 padi më pak se numri i padive të shqyrtuara në 2022. Duke krahasuar vitin 2023 me vitin 2021, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të të shqyrtuara për këtë vit është ulur me 462 padi më pak të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2020, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të shqyrtuara në vitin 2023


është ulur me 749 padi më pak. Ndërsa në krahasim me vitin 2019, vihet re përsëri një ulje e padive të tjera kontraktuale me 1,075 padi më pak të shqyrtuara në vitin 2023, si dhe më pak çështje të regjistruara në gjykata dy vitet e fundit.

Për vitin 2024 numri i padive të tjera kontraktuale të regjistruara në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm është 861 dhe të shqyrtuara është 379 me një rritje prej 23 padi më shumë se numri i padive të shqyrtuara në 2023. Duke krahasuar vitin 2024 me vitin 2022, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të të shqyrtuara për këtë vit është ulur me 252 padi më pak të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2021, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të shqyrtuara në vitin 2024 është ulur me 439 padi më pak. Ndërsa në krahasim me vitin 2020, vihet re përsëri një ulje e padive të tjera kontraktuale me 726 padi më pak të shqyrtuara në vitin 2024, si dhe më pak çështje të regjistruara në gjykata vitet e fundit.

Për vitin 2025 numri i padive të tjera kontraktuale të regjistruara në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm është 645 dhe të shqyrtuara është 189 me një ulje prej 190 padi më pak se numri i padive të shqyrtuara në 2024. Duke krahasuar vitin 2025 me vitin 2023, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të të shqyrtuara për këtë vit është ulur me 167 padi më pak të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2022, vihet re se numri i padive të tjera kontraktuale të shqyrtuara në vitin 2025 është ulur me 442 padi më pak. Ndërsa në krahasim me vitin 2021, vihet re përsëri një ulje e padive të tjera kontraktuale me 629 padi më pak të shqyrtuara në vitin 2025, si dhe më pak çështje të regjistruara në gjykata vitet e fundit.

Në mënyrë tabelare dhe grafike, po paraqesim krahasimin e çështjeve të shqyrtuara me objekt padi të tjera kontraktuale për pesë vitet e fundit :

Periudha kohore	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Viti 2021	1,570	818	752
Viti 2022	1,248	631	617
Viti 2023	931	356	575
Viti 2024	861	379	482
Viti 2025	645	189	456



Padia për shkaktim dëmi (Nenet 608-654 KC)

Pas padive të pronësisë numrin më të madh të padive civile të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, e përbëjnë paditë për shkaktim dëmi (nenet 608-654 të Kodit Civil).

Për vitin 2021 numri i padive civile për shkaktim dëmi të regjistruara në Gjykata është 2,561 dhe të shqyrtuara është 1,048, pra 161 padi (të shqyrtuara) më shumë se numri i padive të shqyrtuara në 2020. Në krahasim me vitin 2019, në vitin 2021 vihet re se numri i padive civile të shqyrtuara për këtë vit është 323 padi më pak. Duke e krahasuar me vitin 2018, vihet re një ulje numrit të padive civile të shqyrtuara për vitin 2021 me 442 padi më pak. Ndërsa krahasuar me vitin 2017 vihet re përsëri një ulje me 651 padi të shqyrtuara më pak në vitin 2021.

Në vitin 2022 numri i padive civile për shkaktim dëmi të regjistruara në Gjykata është 2,596 dhe të shqyrtuara është 971, pra 77 padi (të shqyrtuara) më pak se numri i padive të shqyrtuara në 2021. Në krahasim me vitin 2020, në vitin 2022, vihet re se numri i padive civile të shqyrtuara për këtë vit është me 84 padi më shumë. Duke e krahasuar me vitin 2019, vihet re një ulje e ndjeshme e numrit të padive civile të shqyrtuara me 400 padi më pak. Në krahasim me vitin 2018 vihet re përsëri një ulje me 519 padi të shqyrtuara më pak në vitin 2022.

Në vitin 2023 numri i padive civile për shkaktim dëmi të regjistruara në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm është 2,598 dhe të shqyrtuara është 706, pra 265 padi (të shqyrtuara) më pak se numri i padive të shqyrtuara në 2022. Në krahasim me vitin 2021, në vitin 2023, vihet re një ulje e ndjeshme e numrit të padive civile të shqyrtuara me 342 padi më pak. Duke e krahasuar me


vitin 2020, vihet re një ulje e numrit të padive civile të shqyrtuara me 181 padi më pak. Në krahasuar me vitin 2019 vihet re përsëri një ulje me 665 padi të shqyrtuara më pak në vitin 2023.

Në vitin 2024 numri i padive civile për shkaktim dëmi të regjistruara në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm është 2,912 dhe të shqyrtuara është 961, pra 255 padi (të shqyrtuara) më shumë se numri i padive të shqyrtuara në 2023. Në krahasim me vitin 2022, në vitin 2024, vihet re një ulje e lehtë e numrit të padive civile të shqyrtuara me 10 padi më pak. Duke e krahasuar me vitin 2021, vihet re një ulje e numrit të padive civile të shqyrtuara me 87 padi më pak. Në krahasuar me vitin 2020 vihet re një rritje me 74 padi të shqyrtuara më shumë në vitin 2024.

Në vitin 2025 numri i padive civile për shkaktim dëmi të regjistruara në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm është 3,137 dhe të shqyrtuara është 980, pra 19 padi (të shqyrtuara) më shumë se numri i padive të shqyrtuara në 2024. Në krahasim me vitin 2023, në vitin 2025, vihet re një rritje e numrit të padive civile të shqyrtuara me 274 padi më shumë. Duke e krahasuar me vitin 2022, vihet re një rritje e lehtë e numrit të padive civile të shqyrtuara me 9 padi më shumë. Krahasuar me vitin 2021 vihet re një ulje me 68 padi të shqyrtuara më pak në vitin 2025.

Në mënyrë tabelare dhe grafike po paraqesim krahasimin e çështjeve të shqyrtuara me objekt padi për shkaktim dëmi për pesë vitet e fundit :

Periudha kohore	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Viti 2021	2,561	1,048	1,513
Viti 2022	2,596	971	1,625
Viti 2023	2,598	706	1,892
Viti 2024	2,912	961	1,951
Viti 2025	3,137	980	2,157



Padi për marrëdhënie pune

Një numër i konsiderueshëm padish të cilat janë paraqitur për t'u shqyrtuar nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë edhe paditë që si objekt të tyre kanë marrëdhëniet juridike ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Për pesë vitet e fundit kemi të dhënat e mëposhtme:

Në vitin 2021 numri i padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara është 1,272. Në krahasim me numrin e padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara në vitin 2020, janë 3 padi për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara më pak. Në këtë vit (2021), rezultojnë 208 padi më pak të shqyrtuara se në vitin 2019. Krahasuar me vitin 2018, rezultojnë 789 padi më pak të shqyrtuara në vitin 2021. Në krahasim me vitin 2017, janë shqyrtuar 363 padi më pak në vitin 2021.

Për vitin 2022 numri i padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara është 953. Në krahasim me numrin e padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara në vitin 2021, janë 319 padi për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara më pak. Në këtë vit (2022), rezultojnë 322 padi më pak të shqyrtuara se në vitin 2020. Krahasuar me vitin 2019, rezultojnë 527 padi më pak të shqyrtuara në vitin 2022. Në krahasim me vitin 2018, janë shqyrtuar 1,108 padi më pak në vitin 2022.

Për vitin 2023 numri i padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara është 892. Në krahasim me numrin e padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara në vitin 2022, janë 61 padi për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara më pak. Në këtë vit (2023), rezultojnë 380 padi më pak të shqyrtuara se në vitin 2021. Krahasuar me vitin 2020, rezultojnë 383 padi më pak të shqyrtuara në vitin 2022. Në krahasim me vitin 2019, janë shqyrtuar 588 padi më pak në vitin 2022.


Për vitin 2024 numri i padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara është 1200. Në krahasim me numrin e padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara në vitin 2023, janë 308 padi për

marrëdhëniet e punës të shqyrtuara më shumë. Në këtë vit (2024), rezultojnë 247 padi më shumë të shqyrtuara se në vitin 2022. Krahasuar me vitin 2021, rezultojnë 72 padi më pak të shqyrtuara në vitin 2024. Në krahasim me vitin 2020, janë shqyrtuar 75 padi më pak në vitin 2024.

Për vitin 2025 numri i padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara është 1,170. Në krahasim me numrin e padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara në vitin 2024, janë 30 padi për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara më pak. Në këtë vit (2025), rezultojnë 278 padi më shumë të shqyrtuara se në vitin 2023. Krahasuar me vitin 2022, rezultojnë 217 padi më shumë të shqyrtuara në vitin 2025. Në krahasim me vitin 2021, janë shqyrtuar 102 padi më pak në vitin 2025.

Në mënyrë tabelare dhe grafike, po paraqesim krahasimin e çështjeve të shqyrtuara me objekt marrëdhëniet e punës për pesë vitet e fundit :

Periudha kohore	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Viti 2021	2,230	1,272	958
Viti 2022	2,019	953	1,066
Viti 2023	2,264	892	1372
Viti 2024	2,647	1200	1,447
Viti 2025	2,667	1170	1,497



ÇËSHTJET CIVILE ME OBJEKT MARRËDHËNIET E PUNËS TË SHQYRTUARA PËR VITIN 2025

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (First Instance Courts of General Jurisdiction)	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Berat	36	21	15
Dibër	27	11	16
Durrës	166	76	90
Elbasan	54	23	31
Fier	173	27	146
Gjirokastrë	44	6	38
Korçë	47	12	35
Kukës	29	14	15
Lezhë	31	21	10
Sarandë	12	12	0
Shkodër	119	30	89
Tiranë	1,586	759	827
Vlorë	343	158	185
T O T A L I	2,667	1,170	1,497

Padi kundërshtim veprimi përmbarimor

Numri i padive të shqyrtuara, objekt i të cilave është kundërshtim veprimi përmbarimor :

Në vitin 2021 numri i padive të regjistruara me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor është 1,019 dhe të shqyrtuara 683. Janë 133 padi më pak të shqyrtuara se në vitin 2021. Janë 496 padi më pak të shqyrtuara sesa në vitin 2019. Krahasuar me vitin 2018, rezultojnë 576 padi me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara për vitin 2021. Duke e krahasuar me vitin 2017 kemi plot 1,095 padi kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara në vitin 2021.

Për vitin 2022 numri i padive të regjistruara me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor është 988 dhe të shqyrtuara 592. Janë 91 padi më pak të shqyrtuara se në vitin 2021. Janë 224 padi më pak të shqyrtuara sesa në vitin 2020. Krahasuar me vitin 2019, rezultojnë 587 padi me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara për vitin 2022. Duke e krahasuar me vitin 2018 kemi plot 667 padi kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara në vitin 2022.


Për vitin 2023 numri i padive të regjistruara me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor është 868 dhe të shqyrtuara 493. Janë 99 padi më pak të shqyrtuara se në vitin 2022. Janë 190 padi më pak të shqyrtuara sesa në vitin 2021. Krahasuar me vitin 2020, rezultojnë 323 padi me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara për vitin 2023. Duke e krahasuar me vitin 2019 kemi plot 686 padi kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara në vitin 2023.

Për vitin 2024 numri i padive të regjistruara me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor është 689 dhe të shqyrtuara 443. Janë 50 padi më pak të shqyrtuara se në vitin 2023. Janë 149 padi më pak të shqyrtuara sesa në vitin 2022. Krahasuar me vitin 2021, rezultojnë 240 padi me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara për vitin 2024. Duke e krahasuar me vitin 2020 kemi plot 373 padi kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara në vitin 2024.

Për vitin 2025 numri i padive të regjistruara me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor është 543 dhe të shqyrtuara 263. Janë 180 padi më pak të shqyrtuara se në vitin 2024. Janë 230 padi më pak të shqyrtuara sesa në vitin 2023. Krahasuar me vitin 2022, rezultojnë 329 padi me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara për vitin 2025. Duke e krahasuar me vitin 2021 kemi plot 420 padi kundërshtim veprimi përmbarimor më pak të shqyrtuara në vitin 2025.

Në mënyrë tabelare dhe grafike, po paraqesim krahasimin e çështjeve të shqyrtuara me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor për pesë vitet e fundit :

Periudha kohore	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Viti 2021	1,019	683	336
Viti 2022	988	592	396
Viti 2023	868	493	375
Viti 2024	689	443	246
Viti 2025	543	263	280



Çështje tregtare

Që në vitin 2008 me ardhjen në fuqi të ligjit të ri për shoqëritë tregtare, gjykatat e shkallës së parë nuk kanë shqyrtuar më çështje pa palë kundërshtare, kompetencë kjo tashmë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si pasojë numri i këtyre çështjeve është reduktuar në shifra minimale.

Megjithatë, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, shqyrtojnë ende dhe padi për çështje tregëtare.

Në vitin 2021 nga Gjykatat e Shkallës së Parë janë shqyrtuar gjithsej **615** çështje tregtare. Nga këto; **33** kërkesa tregtare pa palë kundërshtare. Nga këto; **1** kërkesë për emërim administratori; **4** kërkesa kanë për objekt kërkesë për ndryshim e numrit të ortakëve. Po ashtu janë shqyrtuar edhe **28** kërkesa të tjera të përgjithshme pa palë.

Për vitin 2022 nga Gjykatat e Shkallës së Parë janë shqyrtuar gjithsej **1,234** çështje tregtare. Nga këto; **50** kërkesa tregtare pa palë kundërshtare. Nga këto; **2** kërkesë për emërim administratori; **5** kërkesa kanë për objekt kërkesë për ndryshim e numrit të ortakëve. Po ashtu janë shqyrtuar edhe **43** kërkesa të tjera të përgjithshme pa palë.

Për vitin 2023 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm janë shqyrtuar gjithsej **853** çështje tregtare. Nga këto; **19** kërkesa tregtare pa palë kundërshtare. Nga këto; **9** kërkesë për emërim administratori; **2** kërkesa kanë për objekt kërkesë për ndryshim e numrit të ortakëve. Po ashtu janë shqyrtuar edhe **8** kërkesa të tjera të përgjithshme pa palë.

Për vitin 2024 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm janë shqyrtuar gjithsej **469** çështje tregtare. Nga këto; **17** kërkesa tregtare pa palë kundërshtare. Nga këto; **3** kërkesë për emërim administratori; **4** kërkesa kanë për objekt kërkesë për ndryshim e numrit të ortakëve. Po ashtu janë shqyrtuar edhe **8** kërkesa të tjera të përgjithshme pa palë.

Për vitin 2025 nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm janë shqyrtuar gjithsej **418** çështje tregtare. Nga këto; **19** kërkesa tregtare pa palë kundërshtare. Nga këto; **1** kërkesë për emërim administratori; **1** kërkesë për objekt kërkesë për ndryshim e numrit të ortakëve. Po ashtu janë shqyrtuar edhe **17** kërkesa të tjera të përgjithshme pa palë.

ÇËSHTJE TË SHQYRTUARA PËR VITIN 2025 NGA GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË

Në përputhje me reformën e sistemit gjyqësor dhe në kuadër të përmirësimit të administratës dhe efikasitetit të procesit gjyqësor, është miratuar një hartë e re gjyqësore, e cila përcakton qartë ndarjen e funksioneve dhe kompetencave të organeve gjyqësore në nivel kombëtar. Ky akt ka si qëllim optimizimin e shpërndarjes së çështjeve gjyqësore dhe sigurimin e një qasjeje të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.

Kjo hartë e re synon të kontribuojë në forcimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe transparencës në trajtimin e rasteve, duke mundësuar një proces të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë për të gjithë ata që kërkojnë drejtësi. Zbatimi i kësaj harte do të mbështetet nga institucionet përkatëse dhe do të monitorohet në mënyrë të rreptë për të siguruar përputhshmërinë me parimet e drejtësisë dhe të ligjit. Riorganizimit⁶ do t'i nënshtroheshin dhe gjykatat administrative të shkallës së parë. Kështu, këto gjykata do të riorganizoheshin në dy gjykata nga gjashtë, që kishin ekzistuar më parë në të gjitha zonat, ku ekzistonin dhe gjykatat e apelit, Të fundit, përsa i takon shkrirjes, ishin gjykatat administrative. Këto të fundit u shkrinë më 01.07.2023, ditë në të cilën, filloi punën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Shkallës së Parë Lushnjë.

⁶ Me vendimin nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”

LLOJI I ÇËSHTJEVE (The kind of Cases)	Gjithsej (Total)
A. PADI ME PALË KUNDËRSHTARE	
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ	1,061
Padi për refuzim miratimi akti administrativ	466
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Çështje pronësie)	145
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Padi shkaktim dëmi)	119
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Padi të tjera kontraktuale)	73
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ(Padi kund.veprimi Përmbarimor)	135
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Padi për mardhënie Pune)	60
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Kompesimpër burgim të padrejtë)	52
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Vërtetim për vjetërsi në punë.)	341
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Korigjime në aktet e Gjëndjes Civile)	118
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Të tjera)	12,341
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Çështje pronësie)	9
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Padi shkaktim dëmi)	12
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Padi të tjera kontraktuale)	3
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Padi kundërshtim veprime Përmbarimore)	6
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Padi për mardhënie Pune)	6
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Kompesimpër burgim të padrejtë)	2
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Vërtetim për vjetërsi në punë)	59
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Korigjime në aktet e Gjëndjes Civile)	5
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Të tjera)	5
SHUMA ADMINISTRATIVE A	15,018
B. KËRKESA PA KUNDËRSHTARË	
Kërkesë për lëshim Urdhër Ekzekutimi	5,648
Kërkesë për Sigurim Padie	224
Kërkesë për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Të tjera)	731
Kërkesë për refuzim miratimi akti administrativ (Të tjera)	-
SHUMA ADMINISTRATIVE B	6,603

SHUMA E PËRGJITHSHME

21,621

Për vitin 2025, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë kanë patur gjithsej për të shqyrtuar **21,621** çështje në total, nga të cilat **12,825** çështje kanë përfunduar dhe **8,796** çështje janë ende të papërfunduara.

Numri total i çështjeve administrative me palë dhe pa palë kundërshtare për vitin 2025 të regjistruara në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë ka qenë si më poshtë:

Çështjet (Cases)	Numri i çështjeve (Number of cases) Viti 2025 (Year 2025)	Përqindja (Percentage) Viti 2025 (Year 2025)
Padi me palë kundërshtare (Lawsuit with adversary parties)	15,018	69%
Kërkesa pa kundërshtarë (Demand without opponents)	6,603	31%
Totali	21,621	100%

Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë (First Instance Administrative Courts)	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Tiranë	17,852	10,643	7,209
Lushnjë	3,769	2,182	1,587
T O T A L I	21,621	12,825	8,796

Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë (First Instance Administrative Courts)	Mbartur (Old cases)	Të ardhura të reja (New cases)	Ardhur pas prishjes (Came after reversed)	SHUMA (Total)
Tiranë	6,646	11,206	-	17,852
Lushnjë	1,750	1,934	85	3,769
T O T A L I	8,396	13,140	85	21,621

Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë (First Instance Administrative Courts)	Pranuar (Accepted)	Zgjidhje me pajtim (Resolve with agreement)	Refuzuar (Refused)	Pushuar (Ceased)	Moskompetenca (Incompetence)	Total të përfunduar (Total Examined)
Tiranë	6,897	766	2,132	692	156	10,643
Lushnjë	1,195	-	436	483	67	2,182
T O T A L I	8,092	766	2,568	1,175	223	12,825

AFATET E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE ADMINISTRATIVE

LLOJI I ÇËSHTJEVE (The kind of Cases)	TË PËRFUNDUAR (Examined)
A. PADI ME PALË KUNDËRSHTARE	
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ	434
Padi për refuzim miratimi akti administrativ	160
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Çështje pronësie)	86
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Padi shkaktim dëmi)	70
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Padi të tjera kontraktuale)	50
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ(Padi kund.veprimi Përmbarrimor)	41
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Padi për mardhënie Pune)	43
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Kompesimpër burgim të padrejtë)	43
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Vërtetim për vjetërsi në punë.)	114
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Korigjime në aktet e Gjëndjes Civile)	81
Padi për shfuqizim/ndryshim akti adminstrativ (Të tjera)	5,284
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Çështje pronësie)	-
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Padi shkaktim dëmi)	4
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Padi të tjera kontraktuale)	-
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Padi kundërshtim veprime)	1

Përmbardimore)	
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Padi për mardhënie Pune)	2
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Kompesimpër burgim të padrejtë)	1
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Vërtetim për vjetërsi në punë)	20
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Korigjime në aktet e Gjëndjes Civile)	3
Padi për refuzim miratimi akti administrativ (Të tjera)	3
SHUMA ADMINISTRATIVE A	6,440
B. KËRKESA PA KUNDËRSHTARË	
Kërkesë për lëshim Urdhër Ekzekutimi	5,574
Kërkesë për Sigurim Padie	223
Kërkesë për shfuqizim/ndryshim akti administrativ (Të tjera)	588
Kërkesë për refuzim miratimi akti administrativ (Të tjera)	-
SHUMA ADMINISTRATIVE B	6,385
SHUMA E PËRGJITHSHME	12,825

Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë (First Instance Administrative Courts)	Afati i përfundimit (Term of termination)		
	0-2 muaj (0-2 months)	2-6 muaj (2-6 months)	Mbi 6 muaj (Over 6 months)
	Tiranë	4,345	2,517
Lushnjë	1,160	412	610
T O T A L I	5,505	2,929	4,391

VOLUMI I PUNËS PËR PESË VITET E FUNDIT PËR ÇËSHTJET TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË

Në lidhje me numrin e çështjeve administrative të përfunduara nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë do të analizohet krahasimisht se si ka qenë situata përsa i përket volumit të punës në pesë vitet e fundit.

Në vitin 2021 numri i çështjeve administrative të shqyrtuara nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, arrin në **15,113** çështje duke patur një ulje prej 2,338 çështjesh krahasuar me vitin 2017. Në krahasim me vitin 2018, ka një ulje me 1,827 çështje të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2019, ka një ulje me 1,109 çështje të shqyrtuara. Duke e krahasuar me vitin 2020, në vitin 2021 ka një **rritje relativisht të madhe me 3,105** çështje të shqyrtuara më shumë (por numri i çështjeve të regjistruara është më i madh në vitin 2021).


Për vitin 2022 numri i çështjeve administrative të shqyrtuara nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, arrin në **15,014** çështje duke patur një ulje prej 1,926 çështjesh krahasuar me vitin 2018. Në krahasim me vitin 2019 ka një ulje me 1,208 çështje të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2020, ka një **ritje relativisht të madhe** me 3,006 çështje të shqyrtuara. Duke e krahasuar me vitin 2021, në vitin 2022 ka një ulje me 99 çështje të shqyrtuara më pak.

Për vitin 2023 numri i çështjeve administrative të shqyrtuara nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, arrin në **9,527** çështje duke patur një ulje prej 6,695 çështjesh krahasuar me vitin 2019. Në krahasim me vitin 2020 ka një ulje me 2,481 çështje të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2021, ka një ulje të konsiderueshme me 5,586 çështje të shqyrtuara. Duke e krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 ka një **ulje relativisht të madhe** prej 5,487 të shqyrtuara më pak.

Për vitin 2024 numri i çështjeve administrative të shqyrtuara nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, arrin në **14,762** çështje duke patur një rritje prej 2,754 çështjesh krahasuar me vitin 2020. Në krahasim me vitin 2021 ka një ulje me 351 çështje të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2022, ka një ulje me 252 çështje të shqyrtuara. Duke e krahasuar me vitin 2023, në vitin 2024 ka një **ritje të konsiderueshme** prej 5,235 të shqyrtuara më shumë.

Për vitin 2025 numri i çështjeve administrative të shqyrtuara nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, arrin në **12,825** çështje duke patur një ulje prej 2,288 çështjesh krahasuar me vitin 2021. Në krahasim me vitin 2022 ka një ulje me 2,189 çështje të shqyrtuara. Në krahasim me vitin 2023, ka një rritje me 3,298 çështje të shqyrtuara. Duke e krahasuar me vitin 2024, në vitin 2025 ka një **ulje të konsiderueshme** prej 1,937 të shqyrtuara më pak.

Periudha kohore	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Viti 2021	21,387	15,113	6,274
Viti 2022	22,477	15,014	7,463
Viti 2023	12,371	9,527	2,844
Viti 2024	23,158	14,762	8,396
Viti 2025	21,621	12,825	8,796



DINAMIKA E ÇËSHTJEVE CIVILE SIPAS GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR VITIN 2025

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (First Instance Courts of General Jurisdiction)	Mbartur	Të ardhura të reja	Ardhur pas	SHUMA
	(Old cases)	(New cases)	prishjes (Came after reversed)	(Total)
Berat	872	1055	2	1,929
Dibër	285	640	13	938
Durrës	2269	3163	19	5,451
Elbasan	1690	1935	0	3,625
Fier	1637	1866	3	3,506
Gjirokastrë	797	652	0	1,449
Korçë	1184	1194	0	2,378
Kukës	234	450	0	684
Lezhë	815	1491	2	2,308

Sarandë	751	940	3	1,694
Shkodër	1111	1151	1	2,263
Tiranë	14769	14569	210	29,548
Vlorë	1577	1946	0	3,523
T O T A L I	27,991	31,052	253	59,296

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE CIVILE

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (First Instance Courts of General Jurisdiction)	Pranuar (Accepted)	Zgjidhje me pajtim (Resolve with agreement)	Refuzuar (Refused)	Pushuar (Ceased)	Moskompetenca (Incompetence)	Total të përfunduara (Total Examined)
Berat	808	3	120	272	22	1,225
Dibër	388	0	50	201	20	659
Durrës	1,788	18	455	960	50	3,271
Elbasan	1,215	5	59	617	39	1,935
Fier	1,027	21	122	388	18	1,576
Gjirokastrë	523	0	101	48	0	672
Korçë	770	2	155	247	12	1,186

Kukës	294	0	95	80	18	487
Lezhë	1056	14	169	321	46	1,606
Sarandë	689	5	96	247	17	1,054
Shkodër	636	17	75	410	32	1,170
Tiranë	9,860	14	4147	1545	219	15,785
Vlorë	1227	2	304	539	47	2,119
TOTALI	20,281	101	5,948	5,875	540	32,745

AFATET E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE CIVILE

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (First Instance Courts of General Jurisdiction)	Afati i përfundimit (Term of termination)			
	0-6 muaj (0-6 months)	6 muaj-1 vit (6 months-1 year)	1-2 vjet (1-2 years)	Mbi 2 vjet (Over 2 years)
Berat	824	205	110	86
Dibër	476	143	37	3
Durrës	1,868	746	439	218
Elbasan	644	451	665	175
Fier	1,049	283	201	43
Gjirokastrë	388	284	0	0
Korçë	575	330	191	90
Kukës	314	119	40	14
Lezhë	1,163	254	148	41
Sarandë	665	215	93	81
Shkodër	647	249	149	125
Tiranë	5,042	4,162	4155	2426
Vlorë	1,151	522	344	102
TOTALI	14,806	7,963	6,572	3,404

ÇËSHTJET CIVILE SIPAS GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ADMINISTRATIVE SIPAS GJYKATAVE ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË PËR VITIN 2025

GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË (First Instance Courts of General Jurisdiction and First Instance Administrative Courts)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)	Gjithsej (Total)
Berat	1,225	704	1,929
Dibër	659	279	938
Durrës	3,271	2,180	5,451
Elbasan	1,935	1,690	3,625
Fier	1,576	1930	3,506
Gjirokastrë	672	777	1,449
Korçë	1186	1192	2,378
Kukës	487	197	684
Lezhë	1606	702	2308
Sarandë	1054	640	1694
Shkodër	1170	1093	2,263
Tiranë	15,785	13763	29,548


Vlorë	2,119	1,404	3,523
Admin.Tiranë	10,643	7,209	17,852
Admin.Lushnjë	2,182	1,587	3,769
T O T A L I	45,570	35,347	80,917

ÇËSHTJE CIVILE DHE ADMINISTRATIVE TË PËRFUNDUARA SIPAS GJYKATAVE TË SHPREHUARA NË PËRQINDJE

GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË (First Instance Courts of General Jurisdiction and First Instance Administrative Courts)	Përfunduar (Terminated)	Përqindja (Percentage)
	Berat	1,225
Dibër	659	1%
Durrës	3,271	7%
Elbasan	1,935	4%
Fier	1,576	3%
Gjirokastrë	672	1%
Korçë	1,186	3%
Kukës	487	1%
Lezhë	1,606	4%
Sarandë	1,054	2%
Shkodër	1,170	3%
Tiranë	15,785	35%
Vlorë	2,119	5%

Admin.Tiranë	10,643	23%
Admin.Lushnjë	2,182	5%
TOTALI	45,570	100%

ÇËSHTJE CIVILE DHE ADMINISTRATIVE TË PËRFUNDUARA



ÇËSHTJE TË ANKIMUARA SIPAS GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË

Gjykatat e Shkallës së Parë (First Instance Courts)	Çështje të ankimuarra (Appealed cases)
Berat	45
Dibër	54
Durrës	312
Elbasan	0
Fier	153
Gjirokastrë	114
Korçë	12
Kukës	9
Lezhë	0
Sarandë	78
Shkodër	234
Tiranë	0
Vlorë	194
Admin.Tiranë	0
Admin.Lushnjë	856
TOTALI	2,061

VOLUMI I PUNËS PËR PESË VITET E FUNDIT TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Në lidhje me numrin e çështjeve civile të përfunduara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm do të analizohet krahasimisht se si ka qenë situata përsa i përket volumit të punës në pesë vitet e fundit.

Në vitin 2021 numri i çështjeve civile të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë së bashku me Gjykatat Administrative, arrin në **70,513**, duke pësuar një **ritje shumë të lartë** prej 21,656 çështjesh krahasuar me vitin 2020 (në këtë vit ka patur edhe një numër të madh çështjesh të regjistruara). Në krahasim me vitin 2019, ka ulje me 1,689 çështje të shqyrtuara. Për vitin 2021 ka përsëri një ulje prej 155 çështjesh krahasuar me vitin 2018. Në krahasim me vitin 2017, janë shqyrtuar 7,687 çështje më pak në vitin 2021.

Për vitin 2022 numri i çështjeve civile të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë së bashku me Gjykatat Administrative, arrin në **65,927**, duke pësuar një **ulje shumë të lartë** prej 4,586 çështjesh krahasuar me vitin 2021 (në këtë vit ka patur edhe një numër të madh çështjesh të regjistruara). Në krahasim me vitin 2020, ka rritje me 17,071 çështje të shqyrtuara. Për vitin 2022 ka përsëri një ulje prej 2,897 çështjesh krahasuar me vitin 2019. Në krahasim me vitin 2018, janë shqyrtuar 4,741 çështje më pak në vitin 2022.

Për vitin 2023 numri i çështjeve civile të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm së bashku me Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë , arrin në **47,209**, duke pësuar një ulje prej 18,718 çështjesh krahasuar me vitin 2022. Në krahasim me vitin 2021, ka **një ulje shumë të lartë** me 23,304 çështje të shqyrtuara 2021 (në këtë vit ka patur edhe një numër të madh çështjesh të regjistruara). Për vitin 2023 ka përsëri një ulje prej 1,647 çështjesh krahasuar me vitin 2020. Në krahasim me vitin 2019, janë shqyrtuar 21,615 çështje më pak në vitin 2022.

Për vitin 2024 numri i çështjeve civile të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm së bashku me Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë , arrin në **53,326**, duke pësuar një rritje prej 6,117 çështjesh krahasuar me vitin 2023. Në krahasim me vitin 2022, ka **një ulje shumë të lartë** me 12,601 çështje të shqyrtuara 2022 (në këtë vit ka patur edhe një numër të madh çështjesh të regjistruara). Për vitin 2024 ka përsëri një ulje prej 17,187 çështjesh krahasuar me vitin 2021. Në krahasim me vitin 2020, janë shqyrtuar 4,470 çështje më shumë në vitin 2024.

Për vitin 2025 numri i çështjeve civile të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm së bashku me Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, arrin në **45,570**, duke pësuar një ulje prej 7,756 çështjesh krahasuar me vitin 2024. Në krahasim me vitin 2023, ka një ulje me 1,639 çështje të shqyrtuara. Për vitin 2025 ka **një ulje shumë të lartë** prej 20,357 çështjesh krahasuar me vitin 2022 (në këtë vit ka patur edhe një numër të madh çështjesh të regjistruara). Në krahasim me vitin 2021, janë shqyrtuar 29,943 çështje më pak në vitin 2025.

Duke u nisur nga statistikat e mësipërme arrihet në konkluzionin se: volumi i punës për çështjet civile të shqyrtuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

së bashku me Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë për vitin 2025, ka pësuar një ulje në krahasim me vitet paraardhëse.

Çështjet civile & administrative (Civil & Administrative Cases)	Viti (Year) 2021	Viti (Year) 2022	Viti (Year) 2023	Viti (Year) 2024	Viti (Year) 2025
Të përfunduara (Terminated Cases)	70,513	65,927	47,209	53,326	45,570



ZGJIDHJET E MARTESËS

Në rubrikën e çështjeve familjare analiza statistikore është fokusuar kryesisht në krahasimin e zgjidhjeve të martesës për vetë efektin e rëndësisë që ka në jetën shoqërore të një vendi. Analizë kjo e parë në pesë vitet e fundit.

Në vitin 2021 numri i çështjeve familjare të regjistruara gjithsej është **15,572**. Nga ky numër, **10,798** janë regjistruar për zgjidhje martesë. Janë në këtë vit **1,470** padi për zgjidhje martesë të regjistruara **më shumë** se në vitin 2020. Po ashtu janë 246 zgjidhje martesë të regjistruara më shumë sesa në vitin 2019. Në krahasim me vitin 2018 janë 1,902 zgjidhje martesë më shumë të regjistruara për vitin

2021. Dhe duke i krahasuar me vitin 2017, janë 2,842 padi për zgjidhje martesë të regjistruara **më shumë** në këtë vit.


